

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7764 E mërkurë 16 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ADRI NURELLARI



Protestat e studentëve në Tiranë, ngjallën jo vetëm një simpati të madhe në publik, por edhe një shpresë se një valë e re ndryshimesh po i afrohej ...
Vijon në faqet 20-21

Protestat, shpirti i pashuar revolucionar i shqiptarëve

Dje

në "Deutsche Welle"

Nga FATOS MUSLIU



Çfarë parasheh ligji? Ligji për gjuhët parasheh përdorimin e plotë të gjuhës shqipe si në të shkruar ashtu edhe në folur si në Qeveri, Kuvend, organet ...
Vijon në faqen 21

Maqedoni, çfarë ndryshon me zyrtarizimin e gjuhës shqipe?

PRANGA TE SHUMEKERKUARIT, PRAPASKENAT E NEGOCIATAVE. E SHOQEROI ARDI VELIU ME MAKINE LUKSOZE

DOREZOHET KLEMENT BALILI 3 kushtet e arrestimit të "Eskobarit"

- I akuzuari për trafik droge kërkoi proces të drejtë ligjor, të mos keqtrajtohej dhe kushte të mira në qeli

- Reagon SHBA: Bravo policisë dhe shërbimeve partnere. Rama: Nuk u dorëzua, por ishte operacion i policisë

- Berisha paralajmëroi dorëzimin e të kërkuarit: Ka videot e orgjive të qeverisë. Kush është "miku i politikanëve"

Ishumëkërkuari Klement Balili, i cili u vu në pranga mëngjesin e djeshëm akuzohet si kreu i një grupi ...

Vijon në faqet 2-5



(Në foto:) I akuzuari për trafik droge, Klement Balili kur ishte drejtor i Transporteve dhe dje, i filmuar nga gazetari Artan Hoxha



KELI BALILI NE VITIN 2016: AKUZAT E PD NDAJ MEJE, DUAN TE DEMTOJNE RAMEN

Në faqen 5

INVESTIGIMI

"Zëri i Amerikës" i përgjigjet Ramës: Emërime partiake në Burgje, ja faktet

Në faqen 9

LISTA E PLOTE

Gara për 200 vende të lira në mjekësi, ja kërkesat në 12 qarqe të vendit

Në faqet 10-11

SKANDALI

Shkarkimet e paligjshme, shteti humbi 102 milionë dollarë në 5 vite

Në faqen 9

"VIP PAGES"

VIP-at në altar, ceremonitë që priten të bëjnë bujë gjatë 2019

Suplement

Dossier/ Internimi me urdhrin e Hysni Kapos në zonat e thella dhe peripecitë në Martanesh

Uran Butka: Si donin të na hidhnin në Drin me gurë në qafë

"Karrieristja Ana Petani ngriti problemin që Merjemja u martua me djalin e Safet Butkës"

Nga DASHNOR KALOÇI

Zoti Uran, a pati probleme bashkëshortja uaj, Merjemja, që u lidh dhe u martua me djalin e "një armiku të popullit me damkë"? Po sigurisht. Në spitalin e përgjithshëm, ku Merjemja punonte,

Ana Petani, karrieriste, që donte të tregojë e devotshme ndaj partisë, e ngriti problemin se Merjemja kishte marrë birin e Safet Butkës dhe ne, me urdhrin e sekretarit të Komitetit Qendror të Partisë, Hysni Kapos, na larguan nga Tirana për të na vendosur larg kufirit



dhe qendrave të banuara. Me gjithë presionin e madh, Merjemja nuk pranoi të ndahet nga unë, duke thënë: ku të jete ai, do të jem dhe unë. Ku ju dërguan pas këtij urdhri "nga lart"? Fillimisht na çuan në Tropojën e vjetër, por aty ishte afër ...

Në faqet 18-19


DOREZIMI I BALILIT TRAFIKU I DROGES

PËRGJIMET/ Si i instruktonte Balili bashkëpunëtorët, ja mesazhi që e tradhtoi

Trafiku i 670 kg marijuanë në 2016-ën, Greqia, urdhërarresti për Klement Balilin Biznesmeni mohoi akuzat, i cilësoi politike

TIRANË

Ishumëkërkuari Klement Balili, i cili u vu në pran nga mëngjesin e djeshëm akuzohet si kreu i një grupi kriminal që merrej me trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Emri i tij doli gjatë një hetimi, i cili u finalizua në fillim të muajit maj të vitit 2016, nga një operacion i ndërmarrë nga autoritetet greke në bashkëpunim me DEA-n amerikane, ku u sekuestruan mbi 670 kg marijuanë në ishullin Zakintos në Greqinë lindore. Në këtë operacion u përfshi dhe policia shqiptare si dhe autoritetet e disa vendeve të Bashkimit Europian, ku dyshohet të ketë shtrirë rrjetin e trafikut organizata, një prej krerëve të së cilës dyshohet të jetë Klement Balili, i përkufizuar nga mediat greke si "Eskobari i Ballkanit". Një numër i madh anëtarësh dhe drejtuesish të organizatës u arrestuan në Greqi dhe në disa vende të tjera europiane, ndërkohë që Balili vetë mundi të shpëtojë. Fillimisht ai u shfaq publikisht në Sarandë, duke mohuar akuzat dhe duke i cilësuar si politike, ndërsa më pas u zhduk pa lënë gjurmë. Më 14 maj të 2016-ës, autoritetet greke nxorën një urdhër-arresti për të. Më 16 Maj 2016 udhëroi do të mbërrinte në Shqipëri, por nuk arriti të ekzekutohej pasi Balili nuk u gjet nga policia. Mes institucioneve shqiptare pati një pingpong të gjatë të hedhjes së përgjegjësisë, mes policinë, e cila deklaroi se kishte kërkuar urdhër arresti nga prokuroria, ndërkohë që kjo e fundit, kishte shpjeguar se nuk mund të vepronte për sa kohë nga hetimi nuk kishin dalë prova për veprimtari të paligjshme në Shqipëri, e se për këtë arsye ishin kërkuar materiale nga pala greke. Dosja për Balilin nga Greqia mbërriti në fund të vitit të shkuar, dhe policia organizoi gjatë muajit dhjetor disa operacione për kapjen e tij, të cilat rezultuan të pasuksesshme. Që në momentet e para, rasti Balili u vesh me dyshime të forta. Mediat



Faksimile e përgjimeve

KUSH ËSHTË KLEMENT BALILI

Për dy vite, Klement Balili ka qenë drejtor i Drejtorisë Rajonale të Transportit në Sarandë, i emëruar në 2014 nga LSI-ja. Njëri nga nipat e Balilit ishte zgjedhur në atë kohë kryetar i Bashkisë së Delvinës, në jug të vendit, nën siglën e LSI-së, ndërsa një vëlla i tij ka qenë, gjithashtu, koordinator i LSI-së po në jug të vendit. Vëllëzërit Balili kanë patur aktivitete të shumta tregtare që nga transporti te ato të sigurisë së objekteve, apo peshkimit. Vitin e shkuar, ndaj pasurive të tij u vendos sekuestru.

greke si CNN grek në atë kohë hyri në polemika me ambasadën shqiptare në Athinë pasi botoi një shkrim, në të cilin duke iu referuar burimeve të autoriteteve greke, theksonte se oficerë të policisë shqiptare u kishin deklaruar partnerëve greke gjatë një takimi sekret në Shqipëri se "baronin shqiptar" nuk mund ta arrestonin për shkak se ai kishte mbrojtje politike në Tiranë. Klement Balili ka qenë për 2 vite drejtor i Drejtorisë rajonale të Transportit në Sarandë, i emëruar në 2014 nga LSI-ja. Njëri nga nipat e Balilit ishte zgjedhur në atë kohë kryetar i Bashkisë së Delvinës, në jug të vendit, nën siglën e LSI-së, ndërsa një vëlla i tij ka qenë, gjithashtu, koordinator i LSI-së po në jug të vendit. Vëllëzërit Balili kanë patur aktivitete të shumta tregtare që nga transporti te ato të sigurisë së objekteve, apo peshkimit. Ndërsa në 2015-ën inaugurua

an një investim mjaft të shtrenjtë duke kthyer ish-kampin e punëtorëve në Sarandë në një hotel luksoz. Në ceremoninë e organizuar në muajin gusht, morën pjesë dhe zyrtarë të lartë shtetërorë. Vitin e shkuar, ndaj pasurive të tij u vendos sekuestru. **PËRGJIMET PËR BALILIN** Për mes përgjimeve, autoritetet greke kanë zbardhur biseda mes Klement Balilit dhe trafikantëve të drogës në dy numrat e telefonit që përdorte shqiptari i konsideruar si "Eskobari i Ballkanit". Nga zbardhja e këtyre bisedave, duket qartë që komunikime ka pasur gjatë periudhës 4 deri 7 maj të 2016, biseda që kryeshin vetëm pas orës 23:00 të natës. Thua-se të gjitha bisedat e bëra me bashkëpunëtorët e tij në Greqi, janë pas mesnate, sidomos për organizimin dhe nisjen e skafit të mbushur me rreth 679 kg hashash drejt Greqisë

mesnatën e 6 majit 2016, thuhet në dosjen e prokurorisë. Në bisedat me dy skafistët shqiptarë, Petro Dalanaj dhe Kleanthi Palaj tashmë të arrestuar në Greqi, Balili i instruktonte për rrugën që do ndiqnin në det për t'u ankoruar në brigjet e Sarandës për t'u ngarkuar me hashash. Biseda e parë, rezultoi e kryer rreth orës 23:00 të darkës, kur edhe e njoftoi për kohën e ankorimit në njërin nga gjiret e Sarandës ku e pret mjeti me hashashin. Pas ngarkesës, Balili rezultoi se e kontakton rreth orës 02:00 pas mesnate përsëri Petro Dalanaj, duke porositur që të ketë kujdes me zhurmën dhe ndriçimin në skaf kur të largohet nga bregu për t'u nisur drejt vendeve ku nuk mund të pikaset nga policia kufitare. Bisedat janë të shpeshta pas kësaj ore, deri në momentin që rreth orës 04 të mëngjesit të datës 5 Maj, skafistët shqiptarë e sigurojnë shefin e tyre në Sarandë, Klement Balilin se skafi është fshehur në vendin e përcaktuar. Më pas, ditën e nesërme, pikërisht më datën 6 maj 2016 pas mesnate Balili përsëri rezultoi se komunikoi me skafistët e tij, duke i porositur për rrugën që do ndiqnin drejt ishullit të pabanuar grek, ku e prisnin bashkëpunëtorët e tij të rrjetit të trafikut të drogës. Sipas këtyre materialeve, bisedat mes tyre janë të shpeshta deri në mëngjesin e hershëm të datës 7 maj ku skafistët dorëzojnë mallin të pala greke, ku prisnin 4 punonjësit e biznesmenit grek Georgios Alyfantis. Një ditë më pas, ndërhyjnë policia duke arrestuar të gjithë grupin në Greqi dhe shpallë në kërkim biznesmenin sarandiot Klement Balili. Ky i fundit, sipas autoriteteve greke, që në momentin e arrestimit të bashkëpunëtorëve në Greqi, nuk i ka hapur aparatet celular dhe numrat me të cilët bisedonte me shtetasit grekë e skafistët e tij tashmë të arrestuar. **MESAZHI QË TRADHTOI BALILIN** Nga përgjimet është zbardhur dhe biseda mes të shumëkërkuarit Klement



Balili, skafistit të drogës: Si të hysh në gjirin e Sarandës

Më 23 shtator të vitit 2016, gazeta greke "Kathimerini" publikoi një përgjim, për të cilin shkruan se është zëri i Klement Balilit dhe një skafisti që ndodhej në Gjirin e Sarandës për të marrë drogën. "Balili është një drejtues i organizatës, që ka për detyrë furnizimin me lëndë narkotike, në mënyrë të paligjshme nga Shqipëria në Europë", -tha për gazetën një oficer 34 vjeç, që mori pjesë në hetim. Në një tjetër pikë të dëshmisë së tij, i njëjti oficer, zbulon se Balili siguronte kalimin e kamionëve, pa u kontrolluar në pikat doganore kur kalonin në Greqi dhe u dërgonte para anëtarëve të organizatës përmes kompanive të transfertave të parave. Konkretisht sipas gazetës, më 5 maj të 2016, Balili dëgohet t'i japë urdhra drejtuesit të skafit që ndodhej në Gjirin e Sarandës, për të marrë drogën. Skafisti: "Tani jam në mes të gjirit". ?alili: "Në mes të gjirit tim" Skafisti: "Në Gjirin e Sarandës". ?alili: "Ec avash avash".

Balili dhe Petro Dalanaj, ky i fundit i arrestuar për trafikim të lëndëve narkotike. Përveç mesazheve të shkëmbyera mes tyre, është zbuluar edhe mesazhi që tradhtoi Klement Balilin. Bëhet fjalë për një bisedë me një tjetër person i quajtur Alifandis Georgios, të cilit Balili i dërgon numrin e tij të pasaportës. Konkretisht, identifikimi i tij është bërë me sms-të e mëposhtme: CD 211 - Numri i bisedës: 161. (6971713347 - Alifandis, Georgios me - 0671713372 - Person i panjohur (shqiptar) (datë 11/03/2016, ora 12:42). Mesazh dalës nga numri i telefonit 00306971713372: "Vëllai im, dërgo numrin e pasaportës tënde." Në dokumentin tjetër zbardhet biseda mes Balilit dhe Dalanajt, si më poshtë:

Dalanaj: Hë re vëlla. Kely: Hajde avash avash. Dalanaj: Eee. Kely: Futu avash avash, ec. Dalanaj: Po vij. Kely: Do daleh nga maja dhe do futesh në gjirin e madh. Dalanaj: E di ore e di. Atje ne ane ku zbrasin makinat? Kely: E, siç futesh në plazh Dalanaj: Siç është rruga, hajde. Kely: Eee, nga ana e brendshme që është, jo nga ana tjetër. Dalanaj: Ku është rruga, hajde. Kely: Ee nga ana e brendshme, jo nga ana tjetër. Dalanaj: Jo atje; nga ana e brendshme. Kely: Nga brenda. Dalanaj: Erdha, erdha, hajde.



TIRANË

Klement Balili, i ashtu quajtur si Eskobari i Ballkanit, "Baroni i drogës", "Peshku i madh" apo "Magjistari" ka përfunduar në pranga. Pas më shumë se dy vitesh arrati, 46-vjeçari nga fshati Stjar i Delvinës i shumëkërkuar për trafik ndërkombëtar të drogës është vetëdorëzuar në polici. Mësohet se Balili është dorëzuar mëngjesin e djeshëm nën shoqërimin e avokatit të tij mbrojtës, në prag të përfundimit të hetimeve dhe të dërgimit të dosjes së tij në gjykatë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Ai akuzohet për katër vepra penale dhe konkretisht: "Trafikim të lëndëve narkotike", i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal; "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal"; "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash". Burime për "Gazeta Shqiptare" bëjnë me dije se Klement Balili u dorëzua pas 3 muaj negociatash mes drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe nipit të tij, Rigers Balili, me detyrë kryetar i bashkisë së Delvinës. Por, pavarësisht vetëdorëzimit të tij në prani të njërit prej familjarëve të tij, policia pretendon se 46-vjeçari nuk e përballoi dot presionin dhe rrethimin policor, të paktën gjatë dy muajve të fundit, duke ngushtuar zonën ku Balili strehohej, në Delvinë. Për këtë arsye, Klement Balili ra në duart e uniformave blu, pas negociatave edhe me drejtues të Policisë së Shtetit. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj në një deklaratë për mediat deklaroi se operacioni për dorëzimin e Klement Balilit kishte qenë i gjatë dhe i ndërlikuar. Ndërsa avokati mbrojtës i Balilit, Theodhori Sollaku tregoi se klienti i tij u vetëdorëzua kur u plotësuan kushtet.

DORËZIMI I BALILIT

Një nga emrat më të lakuar të botës së krimit, Klement Balili u vetëdorëzua, duke pranuar të përballte me drejtësinë. Dorëzimi i tij, vjen pak ditë pas mbërritjes së letërporosisë nga Greqia. Mësohet se 46-vjeçari u vetëdorëzua dhe në orën 8:45 te kthesa e Shijanit, mes Delvinës dhe Finiqit, ndërsa gjithçka u bë në prani të drejtorit të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu. Behet me dije se Balili ka qenë i shoqëruar nga nipi i tij, Rigers Balili. Fillimisht, i shumëkërkuari është takuar dhe përshëndetur me familjarët e tij në fshatin Stjar dhe më pas është nisur në drejtim të Tiranës i shoqëruar nga eskorta e Policisë së Shtetit ku i pranishëm ishte edhe drejtori

Ministri Lleshaj: Operacioni u finalizua me partnerët, Balili u detyrua të dorëzohet

Vetëdorëzohet pas 2 vjetësh në arrati, "Eskobari i Ballkanit", Klement Balili

3 muaj negociata mes kreut të policisë dhe nipit, ja 3 kushtet e vendosura për dorëzim nga i shumëkërkuari



46-vjeçari i vetëdorëzuar, Klement Balili



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

KUSHTET E VETËDORËZIMIT

Klement Balili, ka vendosur tri kushte për t'u dorëzuar në polici dhe konkretisht: Të mos keqtrajtohej, proces të drejtë ligjor si dhe të deklarohet vetëdorëzimi. Ai akuzohet për katër vepra penale dhe konkretisht: "Trafikim të lëndëve narkotike", i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal; "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash.

"Provat janë të dyshimta, s'ka asnjë bisedë të përgjuar"

Avokati Sollaku: Balili s'iu shmang drejtësisë, u vetëdorëzua kur u plotësuan kushtet

TIRANË - Pas takimit me klientin e tij, Klement Balili në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, avokati Theodhori Sollaku ka dhënë një prononcim për mediat. Ai theksoi se për asnjë cast klienti i tij nuk i ishte shmangur drejtësisë, ndërsa shtoi se ai u vetëdorëzua kur u plotësuan kushtet. Mes të tjerash ai shtoi se tashtë që kishte ardhur letërporosia nga Greqia, Balili u dorëzua, duke shmangur sipas tij edhe harrxhimet që do të kishte shteti shqiptar për qëndrimin e tij këtu dy vite në burg. "Ishte në polici për t'u përballur me akuzat janë ngritur ndaj tij. Është e vërtetë që ka dy vite që është në kërkim policor. Trysnia ka qenë e madhe për ta arrestuar edhe pse s'ka prova. Prokuroria ka kërkuar prova nga autoritetet greke. Tani që er-



dhi letërporosia dhe hetimet janë drejt përfundimit shtetasi Klement Balili vendosi të dorëzohet. Dhe shteti në këto dy vite do harxhonte lekë, do e mbante me ushqime dhe do kishte kosto. Ju e dini që një i burgosur e ka koston 50 euro në ditë, pra 50 mijë euro, por nuk është kjo kryesore", pohoi Sollaku. Ndërkaq, ky i fundit u shpreh se provat

ndaj Balilit janë të dyshimta dhe se nuk ka asnjë bisedë të përgjuar. "Balili nuk i është shmangur drejtësisë se në 2 vjet prokuroria nuk ka kryer asnjë veprim procedural që të ishte e domosdoshme prania e tij. Ditët e fundit është negociuar mes policisë dhe familjarëve dhe sot është dorëzuar në Sarandë. Nuk ka kërkuar asnjë garanci. Ne jemi në përfundim të fazës së hetimit do njihemi me aktet dhe këtu do të jemi në vazhdim. Në gjykimin në themel do të shohim si do veprojmë, pasi provat janë të dyshimta. Nuk ka asnjë bisedë të përgjuar, por pretendohet se numri i telefonit grek i përket Klement Balilit, ndërkohë që kushdo që blen numër telefonit, identifikohet me pasaportë dhe kartë identiteti", pohoi ndër të tjera Sollaku.

ditët në vijim Balili pritet që të dalë para gjykatës për njohjen me akuzat. Në lidhje me vënien në pranga të Klement Balilit ka dhënë mesditën e djeshme një deklaratë për mediat dhe ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj.

DEKLARATA E LLESHAJT

"Policia shqiptare ka finalizuar sot (dje) një operacion të gjatë, të ndërlikuar dhe shumë të rëndësishëm, për dorëzimin e Klement Balilit, pas një procesi operativogjurmuess, në bashkëpunim me shërbimin sekret shqiptar dhe me partnerët tanë. Nga sot (dje), drejtësia shqiptare merr në duart e saj njërin prej personave më të kërkuar në Shqipëri dhe përtej saj, ndërsa qytetarët dhe partnerët e vendit tonë marrin, jo vetëm një lajm të rëndësishëm, por dhe një mesazh shumë të qartë për Shqipërinë që duam. Arrestimi i sotëm (djeshëm) është një rezultat shumë domethënës për drejtësinë në Shqipëri dhe një provë e qartë se Policia e Shtetit është në një nivel krejt të ri gatishmërie për t'u përballur në emër të ligjit e të njerëzve të zakonshëm të këtij vendi", tha ndër të tjera Lleshaj. Ndërkaq i pyetur se çfarë keni negociuar me Balilin, ministri Sandër Lleshaj u shpreh se: "Detaje operationale nuk mund t'ju jap. Ndërsa, i pyetur se çfarë sigurie i ofruat atij që u vetëdorëzua, Lleshaj u përgjigj: Sigurinë e një procesi të drejtë ligjor.

Flet nipi i

Balilit: Nuk është arrestuar, ja pse nuk dorëzohet më parë

TIRANË - Nipi i Klement Balilit, ka qenë personi që e ka shoqëruar atë deri në ambientet e komisarariatit. Rigers Balili ka theksuar edhe njëherë se Klementi nuk është arrestuar, por është vetëdorëzuar. "Negociatat kanë nisur që në momentin kur na njoftuan se është plotësuar dosja dhe është gati për t'u dorëzuar në gjyq. Sot bëmë të mundur dorëzimin në Drejtorinë e Policisë. Nuk është arrestuar, është vetëdorëzuar. Kam shkuar unë në zyrën e drejtorit të policisë dhe kam bërë negociatën", është shprehur Rigers Balili. Më tej ai është shprehur se nuk ka mundur ta pyes se ku ka qenë gjatë kësaj kohe, pasi vetëm e ka shoqëruar përgjatë dorëzimit të tij. "Nuk ka qenë fare e vështirë, në moment që dosja do të shkonte në gjyq ai u kishte thënë familjarëve që nuk do të fshihej, por do të shkonte të përballje me drejtësinë. Nuk ka pasur asnjë kusht për këtë", tha më tej ai. I pyetur nëse Balili ka kërkuar garanci nga autoritetet e policisë për të mos u ekstraduar drejt Greqisë, nipi thotë: "Asnjë garanci, ai ka thënë se është i pafajshëm, ka deklaruar se nuk mund të rrinte në paraburgim sa kohë që të bëhej dosja për gjyq, kur u bë gati, atëherë u dorëzua, nuk është arrestuar.

Ardi Veliu. 46-vjeçari u dërgua në ambientet e komisarariatit nr.6 në Tiranë nën masa të rrepta sigurie, ku i pranishëm ishte edhe drejtori i policisë. Pasi u mor në pyetje në komisarariat nr.6, ai u shoqërua drejt Drejtorisë së Policisë së Tiranës me një mak-

inë Shqiponja, ndërsa brenda saj kishte 6 efektive. Ky mjet shoqërohej edhe nga dy makina të tjera me punonjës policie. Ndërkaq, mësohet se Klement Balili kishte vendosur tri kushte për t'u dorëzuar në polici dhe konkretisht: Të mos keqtrajtohej,

proces të drejtë ligjor si dhe të deklarohet vetëdorëzimi. Plot 15 operatione policore kanë dështuar për kapjen e Klement Balilit, i cili cilësohet si "Eskobari i Ballkanit", ndërsa shpesh herë nuk kanë munguar akuzat se ka pasur dekonspirim. Në dy

DOREZIMI I BALILIT LIDHJET POLITIKE

"Miku i politikanëve" u la 7 muaj pa u shpallur në kërkim, sepse "u vonua dosja"

Pingpong institucionesh, si u bllokua urdhërarrestet për Balilin

Interpoli e shpalli në maj 2016, Shqipëria në dhjetor

Klement Balili ka qenë i shpallur në kërkim nga Interpoli që më 17 maj të 2016. Kështu, urdhër arresti ndërkomëtar, i cili ishte firmosur nga autoritetet greke për të ashtuquajturin "Eskobari i Ballkanit" e detyronte policinë e vendit tonë ta arrestonte atë.

Por një gjë e tillë nuk ndodhi, çka ka bërë që deri më tani autoritetet shqiptare të luajnë pingpong në lidhje me dijeninë për këtë urdhër. Në dhjetor 2016, Ministria e Drejtësisë bëri publike një material, ku hidhej dritë mbi faktin se Zyra Qendrore e Interpol Tirana e ka pasur në duar urdhër arrestin që më 17 maj 2016, ditë që grekët e shpallën në kërkim Balilin për veprën penale "Krijim dhe drejtim organizate kriminale". Sipas autoriteteve greke, Balili është konsideruar si kreu i një grupi kriminal në trafikun e drogës nga Shqipëria drejt vendeve të Bashkimit Europian.

Kronologjia e publikuar nga Ministria e Drejtësisë u bë publike vetëm pak ditë pasi ambasadori Donald Lu tha se policia ka dështuar me arrestimin e Klement Balilit. Kështu, Ministria e Drejtësisë bëri me dije se më datë 17 maj 2016 është njoftuar me shkresë zyrtare nga Ministria e Brendshme, konkretisht zyra e Interpolit, se Klement Balili ishte shpallur në kërkim nga Interpol Athina, për akuzat e "Krijimit dhe drejtimit të Organizatës Kriminale" me qëllim trafikimin e drogës.

Për urdhër arrestin është vënë në dijeni edhe Prokuroria e Përgjithshme, duke i kërkuar të veprohet. Korrespondenca ka nisur më 11 maj 2016, ku Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar përcjelljen e letër porosisë për ndihmë juridike, drejtuar autoriteteve greke të drejtësisë. Kjo kërkesë për ndihmë juridike është administruar në Ministrinë e Drejtësisë. Po në të njëjtën ditë (11 maj), Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë Ministrisë greke të Drejtësisë letër porosisë e



Faksimile e gazetave të korrikut 2006 që lajmërojnë arrestimin e parë për drogë të Klement Balilit

Lidhjet politike të Balilit që ishte drejtor Transportesh

Balili rezultoi një person me lidhje të shumfishta politike. Kryetari aktual i Bashkisë Delvinë, Rigels Balili, i ditëlindjes 1985, është nip i të dyshuarit. Ai fitoi zgjedhjet i kandiduar nga Partia Lëvizja Socialiste për Interim me 72 për qind të votave. Lidhjet politike të Klement Balilit shfaqen edhe



Prokurorisë Krimeve të Rënda, duke e vënë në dijeni edhe këtë të fundit. Korrespondenca mes institucioneve ka vazhduar deri në 25 maj 2016 dhe prej asaj kohe deri në nëntor të 2016, ditë kur autoritetet greke sollën në Shqipëri dosjen volumi-

noze të Klement Balilit, për arsye të panjohura nuk ka pasur asnjë letërkëmbim tjetër mbi çështjen e Klement Balilit. Ndërkaq, vetëm pas mbërritjes së dosjes u veproua dhe me kërkesën e Prokurorisë për Krime të Rënda, gjykata

në një kronikë televizive, ku kreu i Kuvendit Ilir Meta, Ministri i Financave Arben Ahmetaj dhe ish-deputeti i zonës Koço Kokëdhima, shfaqen në ceremoninë e inaugurimit të hotelit Santa Quaranta, një investim multimilionësh për një hotel luksi në qytetin e Sarandës, pronë e familjes Balili.

caktio masën e sigurisë "arrest me burg" në mungesë për Klement Balilin. Kështu, që prej datës 9 dhjetor 2016, i cilësuar "Eskobari i Ballkanit" ishte zyrtarisht i shpallur në kërkim, pasi gjykata vendosi masën "arrest me burg".



Makina e Klement Balilit duke shkuar në pikën e takimit me policinë

DOKUMENTET

"Eskobari" organizoi trafikun e kanabisit

Sipas dokumenteve policore greke, Balili akuzohet si Sorganizatori i transportit të fundit të drogës, të kapur nga autoritetet e fqinjët tonë jugor. Në fund të prillit të vitit në fjalë 2016, Klement Balili organizoi transportin nëpërmjet detit nga Shqipëria drejt Greqisë të një sasive të madhe kanabisi të papërpunuar (678,500 gr) në marrëveshje të plotë me koordinatorin e transportit Gjeorgjio Alifandis, asistuar nga Ksendofonda Anagnostopulo, të ngarkuar edhe në llogari të anëtarëve të tjerë të organizatës kriminale me gjetjen e kamionëve për transportimin e sasisë së narkotikëve, magazinimin e përkohshëm të saj në shtetin grek dhe transportimin e mëtejshëm të saj drejt vendeve të Evropës Perëndimore përmes Greqisë", thuhet në dokumentin e referimit të veprës penale, sipas BIRN. Mësohet se droga është nisur nga bregdeti shqiptar pranë Sarandës për në bregdetin grek duke kaluar nga ana perëndimore e ishullit të Korfuzit, ku është fshehur në një zonë të pabanuar në brigjet e Greqisë së veriu.



Petro D., një 59-vjeçar nga Saranda, i cili luante rolin e skafistit në këtë organizatë, si dhe shoqëruesi i tij, 22-vjeçari Kleanth P. nga Borshi, janë të arrestuar nga policia greke. Mësohet se identiteti i vërtetë i 59-vjeçarit është Përparim, por e ka ndryshuar atë në Petro. Dalanaj, disa kohë më parë, ai ka pasur në pronësi një disko vore në Borsh, ku ka edhe një banesë. Zyrtarisht 59-vjeçari Petro Dalanaj është i regjistruar si biznesmen në fushën e peshkimit dhe tregtisë së peshkut në Borsh.

Shoqëria përparimëre JUSTITIA
Shoqëria përparimëre JUSTITIA shpall ankandin, faza e tretë, për shijën e pasurisë së paluajtshme, për të cilin ka vënë hipoteke NBS Bank/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji njësi me sip. 189 m2 nr.pasurie 5/188/nd-1, zk.8350 vol 28 fq.146 RR.P.Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLII. Çmimi me të cilin fillon shija në ankand është 161784 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e tetëdhjetë e katër) EUR.
Lloji apartament sip.132m2 zk.8350 nr.pas.5/188/nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Arjan Rahmi BAHOLLII.
Çmimi me të cilin fillon shija në ankand është 66.528 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë) EUR. Secili ofertues që do të marrë pjesë në ankand duhet të deponojë si garanci shumën prej 10% të çmimit fillestar, në llogarinë e Shoqërisë Përparimëre Justitia që është pranë Bankës "BKT Bank" sh.z. me numër IBAN AL33005110244419501 PRCPJ ALLA.
Ankand zhvillohet në datën 12.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbauesit gjyqësor, me adresë "Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +35542270890



Deklarata në tetor 2016 kur ndodhej në arrati, i kërkuar për trafik droge

Klement Balili: Sulm i Berishës dhe opozitës për të dëmtuar Edi Ramën

Letra në gazetën "Etnos": Histori e sajuar

Klement Balili, shqiptari i cilësuar nga policia dhe mediat greke si "Escobari i Ballkanit" foli në tetor 2016 për herë të parë duke thyer heshtjen për akuzat që rëndonin ndaj tij për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Ish-drejtori i Transportit në Sarandë, në një intervistë për median greke "Etnos", ka mohuar akuzat e ngritura ndaj tij nga autoritetet greke. Balili i ka cilësuar ato si një rast për t'u shfrytëzuar politikisht dhe me qëllim që të dëmtojë kryeministrin Edi Rama.

LETRA E BALILIT

Media greke ka botuar një letër të Balilit, i cili e ka publikuar me anë të avokatit të tij grek. "E gjithë historia, siç mësova nga avokati im Alexis Kougias, është e sajuar dhe nuk ka prova kundër meje, por vetëm një skenar i ndërtuar në mënyrë arbitrare nga policia duke u bazuar në një kontakt timin me anë të telefonit për një çështje kretësisht pa lidhje me një nga personat që aktualisht është i përfshirë në këtë rast. Unë e dija se ai person kishte sjellje të jashtëligjshme. Jam i sigurt se disa anëtarë të policisë e ndërtuan këtë hetim ndaj meje së bashku me ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha, për shkak se nipi im, i cili është avokat, është anëtar i rëndësishëm i Partisë në pushtet në Shqipëri dhe për këtë arsye ata krijuan këtë rast për shfrytëzuar atë politikisht dhe të dëmtojnë kryeministrin Edi Rama", thuhet në reagim.

"Disa persona, duke njo-hur legjislacionin në Shqipëri, kanë vendosur që të lëshojnë edhe një stuhi mediatike në vendin tim, por autoriteteve shqiptare dhe nuk u kanë dhënë asnjë element të hetimit. Ata kanë kaluar muaj e muaj duke e rikthyer historinë time në Greqi dhe Shqipëri, dhe edhe pse vazhdimisht autoritetet shqiptare kanë kërkuar informacion, autoritetet greke nuk kanë dërguar asnjë dokument të vetëm. Avokati im në Greqi, Kougias vazhdimisht bën përpjekje për të dërguar këto dokumente me qëllim që autoritetet shqiptare të vendosim për të ekzekutuar urdhrë ose jo urdhrin e dhënë nga Greqia, dhe këta nuk e kanë bërë", tha ai.

AKUZAT PËR TRAFIK

Klement Balili hodhi poshtë akuzat se merret me trafikim të lëndëve narkotike, ndërsa shton se kjo është shpifje. "Fakti që rasti është ngritur edhe nga



PSEUDONIMI
Nga hetuesit e huaj ka rezultuar se gjatë veprimtarisë së 44-vjeçarit në organizatë, ai përdorte pseudonimin "Keli". Balili mohoi të kishte lidhje me drogën, duke sqaruar se emri i tij ishte duke u përdorur politikisht dhe se kjo nuk është hera e parë që po sulmohej nga opozita.

MEDIA ITALIANE



"Corriere della Sera": Balili ishte një menaxher shteti

2ë një shkrim me titull "Droga, gjuetia e madhe në Europë për 'Escobarin e Ballkanit'", e përditshme italiane "Corriere della Sera" e cilëson 44-vjeçarin shqiptar si një menaxher shteti. "Mbi 7 tonë marijuanë e sekuestruar në një gomone në brigjet e Greqisë ishin të destinuar të mbërrinin në Itali, fillimisht në Salento e më pas drejt Milanos, ku çmimi i drogës rritet 700-800 euro për kg. Në krye të organizatës të kësaj ngarkese droge e të dhjetëra të tjerave ka një të dyshuar, i pagëzuar si 'Escobari i Ballkanit' dhe i kërkuar në gjysmën e Europës. Klement Balili është një njeri i besueshëm i qeverisë shqiptare", shkruan gazeta "Corriere della Sera".

Skandali/ Mediat fqinje zbuluan frikën e policisë shqiptare

CNN: Policia shqiptare i tha asaj greke se Balili s'preket nga lidhjet e forta politike

CNN në gjuhën greke shkruajti në vitin 2016 se Klement Balili ishte një person me lidhje të forta politike dhe prandaj policia druhej të vepronte kundër tij. CNN grek shkruan se "sipas burimeve të tyre, gjatë takimit tejet sekret në Shqipëri, mes policisë greke dhe asaj shqiptare, një pjesëtar i palës shqiptare ka thënë për kreun e kartelit të drogës (sipas autoriteteve greke është Klement Balili), se këtu në Shqipëri nuk mundim ta prekim këtë njeri, veçse po të ketë fakte të pakundërshtueshme, sepse ai ka lidhje politike dhe kontakte me parti e politikanë të nivelit të lartë". CNN shkruan se në sajë të dosjes hetimore, ky person është financuesi i kartelit dhe ai që organizonte në Shqipëri ngarkesat e drogës. Pas kësaj, CNN.GR dhe ambasada shqiptare në Athinë janë përfshirë në replika mbi dyshimet se shqiptarët Klement Balili që cilësohet "si truri" i trafikimit në Greqi të 700 kg marijuanë mbrohet nga politikë të lartë në Tiranë. Pas një shkrimi të CNN në gjuhën greke



ku thuhej se oficerë të policisë shqiptare i kishin deklaruar partnerëve greke gjatë një takimi sekret në Shqipëri se "baronin shqiptar" nuk mund ta arrestonin për shkak se ai kishte mbrojtje politike në Tiranë. Sipas letres së ambasadës shqiptare drejtuar CNN, policia shqiptare, ashtu si çdo pjesëtar i saj që ka hetuar çështjen në fjalë, nuk ka bërë një deklaratë të tillë, ndërsa ka bërë çdo përpjekje për

në ambasadën shqiptare në Athinë, Andi Likaj, vihej në dukje se asnjë pjesëtar i policisë shqiptare nuk ka deklaruar që baroni i drogës ka mbrojtje politike në Tiranë. Sipas letres së ambasadës shqiptare drejtuar CNN, policia shqiptare, ashtu si çdo pjesëtar i saj që ka hetuar çështjen në fjalë, nuk ka bërë një deklaratë të tillë, ndërsa ka bërë çdo përpjekje për

POLICIA SHQIPTARE
Sipas CNN.gr, në takimin mes dy policive, një pjesëtar i palës shqiptare ka thënë se "në Shqipëri nuk mund të preket ky njeri, veçse po të ketë fakte të pakundërshtueshme, sepse ai ka lidhje politike dhe kontakte me parti e politikanë të nivelit të lartë".

hetimin dhe asgjësimin e organizatës". Portali informativ CNN e ka publikuar reagimin e ambasadës shqiptare shoqëruar me faktsimilen e letërës. Por menjëherë ka publikuar edhe një reagim ku ripërsëritet se CNN i është referuar sipas burimeve të tij një takimi tejet sekret në Shqipëri, mes policisë greke dhe asaj shqiptare.

opozita shqiptare dhe pjesëtarë të policisë greke, të cilët kanë bashkëpunuar, ndoshta edhe për simpati të veçanta politike në Greqi

nga ana e partisë së ish-kryeministrin Berisha".

Klement Balili, ish-drejtori i Transportit në Sarandë, që prej muajit maj

2016 u shpall në kërkim pas një hetimi nga DEA amerikane, policia greke e disa polici të vendeve evropiane si kreu i një organizate krim-

inale ndërkombëtare që trafikonte sasi të mëdha të hashashit dhe kokainës në Evropën Qendrore dhe Evropën Perëndimore.

Njoftim për shitje me ankand te II
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë të pasurisë të palës debitore Shoqëria "GIPRA" sh.p.k. e përbërë nga:
- "ARE" - Nr. pasurisë 31/33, në Z. K Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, në Kofthas, Durres. Ankandi i II fillon me çmim fillestar në masën 114,532 Euro.
- "ARE" - Nr. n pasurisë 31/4, në Z. K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12 900 m2, në Kofthas, Durres. Ankandi i II fillon me çmim fillestar në masën 210,073, 92 Euro.
- "ARE" - Nr pasurisë 31/5, Z. K Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4 300 m2, në Kofthas, Durres. Ankandi i II fillon me çmim fillestar në masën 70,024, 64 Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 4.02.2019 ora: 15:00 në selinë: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakti tel: 067628243, Iir: dervishaj@yahoo.com, WEB: www.powerjustice.al.com.

Njoftim për shitje me ankand te dyte
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 568, 577, e vijues te K.P.L.C shpall ankandin e dyte per pasurine e palës debitore Sh "Sirati Construcon" sh.p.k. Pasuria perbehet nga:
- "Are" - Nr. pasurisë 172/23 ndodhur ne Durrës, Z. K Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m2. Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 2.240.000 lekë.
- "Apartament", Nr pasurisë 11/6/1-1/9 ne Kryemadhej Kavaje, Z. K Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 23,19 m2. Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 1.064.000 lekë.
- "Apartament", Nr pasurisë 11/6/1-1/20 ne Kryemadhej Kavaje, Z. K Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59,24 m2 dhe Ankandi fillon me çmim fillestar në masën 1.904.000 lekë.
Ankandi çdonon hapur 30 dite dhe do te zhvillohet ne date 4.02.2019 ne oren 15:00 ne Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Kontakti tel: 00355 67 20 82 543 e-maili Iir: dervishaj@yahoo.com e WEB www.powerjustice.al.com.

ÇESHTJA "BALILI" REAGIMET

Dorëzimi i Balilit, Brukseli: Zhvillim i rëndësishëm në luftën kundër bandave

'Balili', SHBA: Arrestimi hap i madh, gjyq të shpejtë dhe të plotë

"Ju mbështesim, por kush e ka radhën tani?"

Valentina Madani

SHBA dhe BE mirëpritën dje prangosjen e Klement Balilit duke e cilësuar si një zhvillim të rëndësishëm në luftën kundër bandave. Ambasada amerikane reagoi për vetëdorëzimin e të shumtë-kuarit, Klement Balilit, i njohur ndryshe dhe si "Eskobari i Ballkanit". Në një deklaratë publike ambasada amerikane shprehet se arrestimi i Balilit është një hap i madh për popullin shqiptar në rrugën drejt sundimit të zbatimit të ligjit, dhe shërben si një përparim i prekshëm drejt hapjes së bisedimeve me BE. "Ne përgëzojmë Policinë e Shtetit dhe agjencitë ligjzbatuese partnere për arrestimin e trafikantit ndërkombëtar të drogës, Klement Balili. Ky shënon një hap të madh për popullin shqiptar në rrugën drejt sundimit të zbatimit të ligjit, dhe shërben si një përparim i prekshëm drejt hapjes së bisedimeve me BE. Ne mirëpresim një hetim dhe gjyq të shpejtë dhe të plotë. Shtetet e Bashkuara qëndrojnë të gatshme për të ndihmuar Shqipërinë në përpjekjet e saj në luftën kundër krimit të organizuar. #KushEKaRadhën", thuhet në reagimin e Ambasadës së SHBA-ve. Dy vjet pas deklaratës së ish-ambasadorit amerikan, Donald Lu, autoritetet kanë arrestuar Klement Balilin, i quajtur si "Eskobari i Ballkanit". Disa herë, ambasadori amerikan ka përsëritur kërkesën për arrestimin e tij, ndërsa mosarrestimin e ka konsideruar si një dështim të qeverisë, policisë dhe prokurorisë. "Dua të theksoj një dështim të qeverisë, prokurorisë dhe policisë, dështimi për të arrestuar Klement Balilin. Balili është një bos i fuqishëm i krimit të organizuar me lidhje politike", - shpreh Donald Lu në korrik të vitit të kaluar.

BRUKSELI

Për Ambasadorin e Bashkimit Europian në Tiranë, Luigi Soreca, arrestimi i një prej njerëzve më të kërkuar në vend, Klement Balili, është një hap në luftën kundër krimit dhe bandave. Soreca përsëriti



SHBA-të
"Ne mirëpresim një hetim dhe gjyq të shpejtë dhe të plotë. Shtetet e Bashkuara qëndrojnë të gatshme për të ndihmuar Shqipërinë në përpjekjet e saj në luftën kundër krimit të organizuar. #KushEKaRadhën", -thuhet në reagimin e ambasadës amerikane.

"Përgëzojmë Policinë e Shtetit, hap i rëndësishëm"

'Balili', OSBE: Mbështesim Shqipërinë për fuqizimin e shtetit të së drejtës

Prezenca e OSBE-së në Tiranë reagoi dje për arrestimin e Klement Balilit, një person i shumëkërkuar jo vetëm nga autoritetet shqiptare prej kohësh. Në një deklaratë për mediat, OSBE përgëzon policinë shqiptare për arrestimin dhe e cilëson një hap të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar. "Shohim që përpjekjet disavejçare në luftën kundër krimit të organizuar, edhe një herë, po sjellin rezultate konkrete dhe të rëndësishme në Shqipëri. E përgëzojmë Policinë e Shtetit për arrestimin e trafikantit të akuzuar ndërkombëtar të drogës, Klement Balili. Ky është një hap tjetër i rëndësishëm në



luftën e Shqipërisë kundër krimit të organizuar. Ne do të vijojmë të mbështesim përpjekjet e vendit për fuqizimin e shtetit të së drejtës", - shprehet OSBE.


luftën e Shqipërisë kundër krimit të organizuar. Ne do të vijojmë të mbështesim përpjekjet e vendit për fuqizimin e shtetit të së drejtës", - shprehet OSBE.

deti dje dorëzimin në polici të Klement Balilit. Në një postim në Twitter, ai shprehet se vendosja në arrest e Klement Balilit nga Policia e Shtetit paraqet një zhvillim të rëndësishëm në luftën kundër bandave kriminale në Shqipëri. Diplomati evropian deklaroi

se lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës është përparësi kryesore për BE-në në rrugën e Shqipërisë në drejtim të pranimi në BE. "Fakti që Klement Balili është në burg përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në luftën kundër

krimit të organizuar në Shqipëri. Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës është një prioritet kyç për rrugën e Shqipërisë drejt BE", - theksoi z.Soreca në Twitter". Prej muajit maj të 2016 Klement Balili, është shpallur në kërkim me vendim të Gjykatës së Athinës, që ka caktuar masën e sigurisë "arrest me burg". Balili arriti t'i shpëtonet prangave, ndërsa ka dyshime të forta se operacionet janë dekonspiruar nga njerëz që bashkëpunonin me trafikantin e kërkuar edhe nga DEA amerikane. Deri më tani nuk ka asnjë informacion zyrtar lidhur me këtë fakt.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE G-JYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
PASURIA nr. 1/358, e llojit "Truall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në ish-Fushën e Avionit, TIRANË) me sipërfaqe të truallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200,2 m², Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.
CMIMI 25.472.989,70 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 14.02.2019.
CEL: 0684026666 / 0693262866.



Klement Balili

LUIGI SORECA

"Fakti që Klement Balili është në burg përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri. Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të drogës është një prioritet kyç për rrugën e Shqipërisë drejt BE", - theksoi z.Soreca.

Noka: Balili e paralajmëroi vetëdorëzimin kur të vinte dosja nga Greqia!

Ish ministri i brendshëm Flamur Noka deklaroi dje se Klement Balili paralajmëroi vetëdorëzimin kur t'i vinte dosja nga Greqia. "Vetëdorëzimi i Balilit tregon që kemi një shtet të kapitulluar përballë krimit. Vetë Balili ka mbi një vit që paralajmëroi vetëdorëzimin ditën që do të vinte dosja nga drejtësia greke. Që nga ajo ditë ka liva-dhisur për qejf nëpër Shqipëri dhe për policinë dhe qeverinë e mashtruesit, as nuk i hynte e as i ka hyrë gjemb në këmbë... Vetëm një kryeministër mashtrues si Rama mund të bëjë veten kaq qesharak e ta paraqesë vetëdorëzimin si arrestim dhe si sukses të policisë... Qeveria palqosh. Duhet rritur me çdo kusht..."-deklaroi z.Noka. Kurse deputeti tjetër i PD-së Ervin Salianji deklaroi se Balili nuk ka ç'të thotë më, sepse gjatë kohës që ishte në kërkim ai tregoi se ishte i lidhur me Ramën. "Do ishte lajm i mirë nëse Balili do të ishte arrestuar. Nuk besoj se e folura e Balilit tani do të ndryshojë gjë, ai ka folur duke qenë në kërkim. Ai tregoi se ishte i lidhur me Edi Ramën dhe gjithë strukturat e qeverisë", tha Salianji.

PD: Me Ramën kryeministër, Balili mund të fitojë tenderë

Deputeti i Partisë Demokratike Klevis Balliu, i ftuar në rubrikën "Opinion" në 'News 24' deklaroi dje se Klement Balilin nuk e arrestuan, por ky i fundit është vetëdorëzuar në polici. Ai deklaroi se për sa kohë do të jetë Rama kryeministër i vendit, Balili, siç shprehet Balliu, mund të shpallet fitues tenderësh njëlloj si Edmond Bego. "Sot nuk kemi një luftë kundër krimit, sepse nuk mund të presim që Policia të arrestojë persona të tillë. Edhe kur u arrestua Pablo Eskobar, qeveria bënte negociata. Në Shqipëri ajo që do ndodhi sa kohë që është Edi Rama, shumë shpejt Balilin mund ta shihni teksa fiton një tender si Edmond Bego. E para ne këtu duhet të kuptojmë se çfarë loje po luan Rama", - theksoi deputeti i PD-së.



Rama: Hap i madh në luftën ndaj krimit, një përgjigje kuptimplotë për qentë që lehin

Meta: Arrestimi i Balilit nga presioni i ndërkombëtarëve

Basha i përgjigjet Ramës: Pse të djeg e vërteta?

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta përsëriti dje arrestimin e Klement Balilit duke quajtur një person me problem mjaft serioze me ligjin. Kreu i shtetit kujtoi se ishte presioni i gjithanshëm i ndërkombëtarëve, i cili çoi pas hekurave shumë të kërkuar në Klement Balili. Gjatë një prononcimi për mediat nga Lezha, z.Meta foli për ndalimin e Balilit teksa falënderoi agjencitë ligjzbatuese dhe partnerët ndërkombëtarë për këtë rezultat. "Përsëritës ndalimin e Klement Balilit, një person me probleme mjaft serioze me ligjin. Në këtë rast dua të falënderoj jo vetëm agjencitë ligjzbatuese, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë për presionin e gjithanshëm për të arritur këtë rezultat", u shpreh kreu i shtetit Ilir Meta.



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

ILIR META
Përsëritës ndalimin e Klement Balilit, një person me probleme mjaft serioze me ligjin. Në këtë rast dua të falënderoj jo vetëm agjencitë ligjzbatuese, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë për presionin e gjithanshëm për të arritur këtë rezultat", - u shpreh z.Meta.

EDI RAMA

"Prapa hekurave një hap i madh përpara në luftën kundër krimit të organizuar dhe një përgjigje kuptimplotë, për të gjithë qentë që lehin, ndërkohë që karvani do të ecë me vendosmëri përpara: Urime për këtë rezultat Ministrat Lleshi, Policisë së Shtetit dhe SHISH", -tha z.Rama.



"Skema, e njëjtë me atë për Tahirin"

Arrestimi i Balilit, Paloka: Dorëzim i kontrolluar në pakt me Ramën

Për Partinë Demokratike, vetëdorëzimi i Klement Balilit nuk është hap i madh në luftën kundër krimit, por një skemë e kontrolluar dhe menaxhuar në pakt me Edi Ramën. Sipas nënkryetarit demokrat, Edi Paloka ky nuk është sukses i policisë, pasi sipas tij, Edi Rama ka bërë pakt me të shumëkërkuarin më të njëjtën skemë, si me ish-Ministrin Tahirin. Në një dalje për mediat, Edi Paloka tha se pas marrjes nën kontroll të plotë të prokurorisë, skema për Balilin është e njëjtë me atë për Tahirin: dorëzim i kontrolluar, hetim sipërfaqësor, çlirim nga akuzat e rënda për trafik droge. Sipas PD, rasti i Saimir Tahirit do ta provojë së shpejti skemën. Sipas tij, Tahirin do të marrë pafajësi për trafikun e drogës dhe do të shpëtojë me akuzën më të lehtë të shpërdorimit të detyrës. "Vetëdorëzimi i Klement Balilit nuk është hap i madh në luftën kundër krimit, por është skemë e kontrolluar dhe menaxhuar në pakt me Edi Ramën. Vetëdorëzimi i Balilit, që ka patur këto 5 vjet mbrojtjen e qeverisë së Edi Ramës, tregon se policia, qeveria dhe drejtësia janë në duart e Edi Ramës që ka lidhur fatin e tij politik me fatin e krimit", -tha z.Paloka.

DEKLARATA

"Vetëdorëzimi i Balilit, që ka patur këto 5 vjet mbrojtjen e qeverisë së Edi Ramës, tregon se policia, qeveria dhe drejtësia janë në duart e Edi Ramës që ka lidhur fatin e tij politik me fatin e krimit", -deklaroi z.Paloka. Si dëshmi për akuzat e tyre, demokratët tregojnë mos konfiskimin e pasurive të Klement Balilit në Sarandë.

Ish-kryeministri njoftoi i pari vetëdorëzimin

Berisha: Balili u dorëzua, por Rama dhe ministrat janë pengje të tij!

Ish-kryeministri Sali Berisha njoftoi dje i pari lajmin e vetëdorëzimit të Klement Balilit. Në adresë të këtij të fundit mbërriti një mesazh nga qytetari dixhital, i cili informon se Balili është nisur për në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ndërsa thuhet se shoqërohet nga nipi i tij, Rigels Balili. "Dorëzohet Klement Balili! Qytetari dixhital informon. Sb. Përsëritëte doktorin, vetëdorëzohet Klement Balili në prokurorinë e Krimeve të Rënda ai është nisur drejt Tiranës me Rigels Balilin", - thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha. Kurse në një tjetër status në Facebook' ish-kryeministri shpreh se edhe pse Klement Balili u dorëzua në polici, kryeministri Rama dhe Ministrat e tij të kabinetit vazhdojnë të jenë pengje të tij. Në një postim të tij në rrjetet sociale, Berisha shpreh: "Donin të mashtronin me Balilin



VETEDORZIMI

"Klement Balili është dorëzuar nën shoqërinë e avokatit të tij mbrojtës pranë policisë, në një kohë kur Prokuroria e Krimeve të Rënda sapo kishte dorëzuar dosjen hetimore në gjykatë për të paktën 4 vepra penale, më të rëndat e të cilave 'trafik ndërkombëtar droge' dhe 'krijim e pjesëmarrje në një grup të strukturuar kriminal'", - tha Berisha.

ta paraqisnin si arrestim. Ai nuk pranoi. Beteje e madhe për videot e orgjive të Ramës dhe ministrave në Santa Quaranta. Balili nuk dorëzon origjinalin, por kopje tek Ardi Veliu". Klement Balili është dorëzuar nën shoqërinë e avokatit të tij mbrojtës pranë policisë, në

që na kapin ne! Kur dorëzohen jemi ne që u dorëzohemi atyre! Kur nuk kapen jemi ne që s'i kapim dhe kur nuk dorëzohen janë ata që na e hedhin! Ky është avazi opozitar prej 5 vitesh e gjysmë po kjo e sotmja u djeg posaçërisht, e s'kanë faj fare, as njëri, as tjetri", thotë Kryeministri Edi Rama, i cili ka

reaguar edhe herë të tjera gjatë ditës për këtë çështje. I shumëkërkuari Kelmend Balili u vetëdorëzua sot pas negociatave me Policinë e Shtetit, pas 2 vitesh në arratit. Kreu i PD-së Lulzim Basha replikoi me Edi Ramën, pas vetëdorëzimit të Klement Balilit. "Rames i djeg e vërteta sepse Balili

është prova e kapitullimit të tij para krimit. I djeg sepse ka ulur koken para të gjitha kushteve të trafikantit të drogës. I djeg sepse shqiptarët do ta shohin shpejt lehtësimin nga akuzat për trafik droge. E kemi parë keqe film me S. Tahirin", shkruan kreu i PD-së, Lulzim Basha në Twitter.

KRIZA E DEKRETEVE VOTIMI

Thellohet edhe më tej kriza, konflikti mes Presidencës dhe qeverisë. Përveç çështjes së hapur të dekretëve të ministrave dhe konfliktit për marrjen e kompetencave, mes dy prej institucioneve të rëndësishme në vend është shtuar edhe çështja e kthimit të ligjeve për rishqyrtim në Kuvend. Vetëm gjatë ditës së djeshme, presidenti Ilir Meta i ka kthyer qeverisë dy ligje shumë të rëndësishme të miratuara gjatë muajit dhjetor. Fillimisht Meta shpalli dekretin për kthimin e ligjit "Për Noterinë" dhe në orët e vona të mbrëmjes edhe dekretin për kthimin e ligjit "Për Kadastrën". Sa i përket ligjit "Për Noterinë" sipas Presidencës, përmbajtja e nenit 61 të tij, nuk është i

Pas 'Noterisë', Meta kthen në Kuvend edhe ligjin "Për Kadastrën"



qartë dhe në harmoni me disa nene të tjera të këtij ligji. Gjithashtu, sipas presidentit në ligj nuk garantohej trajtimi i barabartë i noterëve përballë kostos që duhet të përballojnë për sigurimin e veprimtarisë së tyre dhe nuk ofro-

het siguri ligjore për mbrojtjen dhe mbështetjen e shtresave të pamundura të shoqërisë. Ndërkohë që lidhur me ligjin "Për Kadastrën" kreu i shtetit në argumentet e tija thekson se ai mbart një sërë problematikash dhe bie ndesh me disa dispozita të tjera ligjore. "Presidenti i Republikës vlerësoi përputhshmërinë e ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" me Kushtetutën, dhe në përfundim të shqyrtimit çmon se disa nene të veçanta të këtij ligji, bien në kundërshtim me legjislacionin bazë të së drejtës civile në Republikën e Shqipërisë; cenonjë

parimin e sigurisë juridike; krijojnë tension kushtetues; si dhe nuk janë në harmoni me jurisprudencën kushtetuese", thuhet në relacionin shoqëruar të këtij dekreti. Gjithashtu, sipas kreut të shtetit sipas këtij ligji e gjithë varësia administrative hierarkike kalon nën përgjegjësinë e Kryeministrit, dhe në këtë mënyrë dispozitat e nenit 6 pika 1, nenit 13 pika 6, nenit 22 pika 2, të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" bien ndesh në mënyrë flagrante me parashikimet e nenit 198 të Kodit Civil.



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

Presidenti nuk ka vendosur ende për dekretimin e Ramës për ministër të Jashtëm

Kuvendi në seancë të jashtëzakonshme, votohen sot ndryshimet në qeveri

"Do jap përgjigj shteruese, me qetësi, por pa dashuri"

Kuvendi do të mbledhet sot në seancë të jashtëzakonshme për të votuar dekretet e presidentit për lirim dhe emërim ministrash. Urdhri është nxjerrë nga Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi, pas kërkesës zyrtare të paraqitur nga kryeministri, Edi Rama për thirrjen e kësaj seance. "Thirrja e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm, krahas garantimit të respektimit të afateve kushtetuese për shqyrtimin e dekretëve të lirim/emërimit i shërben funksionimit normal dhe me kapacitet të plotë të kabinetit qeverisës", - bën të ditur në shkresën e vet Rama.

KONFERENCA

Menjëherë pas kësaj kryeparlamentari, Gramoz Ruçi thirrte edhe mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve për të votuar vendimin për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme. Ndryshe nga sa argumentonte kryeministri në shkresën e vet, opozita kundërshtoi thirrjen e kësaj seance, duke theksuar se ajo ishte anti-kushtetuese. Sipas kryetarit të grupit parlamentar demokrat, Edmond Spaho, Kuvendi nuk arsyë që të mbledhet në një seancë të jashtëzakonshme. "Thirrja



Kryeministri Edi Rama, gjatë një takimi me ministrat

për t'u mbledhur Kuvendi nesër është veprim anti-kushtetues. Kuvendi nuk ka arsye për të patur një seancë të jashtëzakonshme. Maxhoranca e përdor kushtetutën sipas interesit të saj", - tha Spaho pas Konferencës së Kryetarëve. Sipas urdhrorit të dalë nga Kryetari i Kuvendit pas mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, seanca do të mbledhet sot pasdite në orën 17:00 me rend dite të përcaktuar vetëm miratimi i dekretëve. Shumica qeverisëse e la jo pa qellim mbajtjen e seancës pas-

dite, duke shpresuar që kreu i shtetit, Ilir Meta do të dekretojë edhe lirin e Ditmir Bushatit si ministër i Jashtëm dhe emërimin në vend të tij të Edi Ramës. Ndërkohë që burime nga opozita kanë bërë të ditur se pavarësisht se e konsiderojnë anti-kushtetuese mbledhjen Kuvendit, do jenë sot të pranishëm në sallë.

META

Ndërkohë që kreu i shtetit, Ilir Meta nuk ka vendosur ende se çdo bëjë me dy propozimet që ka ende në qeveri dhe që kanë të bëjnë me lirin e

OPOZITA

"Thirrja për t'u mbledhur Kuvendi nesër është veprim antikushtetues. Kuvendi nuk ka arsye për të patur një seancë të jashtëzakonshme. Maxhoranca e përdor Kushtetutën sipas interesit të saj", - tha kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho.

SHKURTE

PD mbledh Këshillin Kombëtar, do zgjidhet kryesia e re

Gati një muaj pas Kuvendit Kombëtar, Partia Demokratike pritet të thërrasë të shtunën Këshillin e Kombëtar, i cili nga ana e tij duhet të zgjedh kryesinë dhe drejtuesit e tjerë të partisë, përveç kryetarit. Kjo është mbledhja e parë e këtij forumi të lartë drejtues, ndërsa në rend dite është parashikuar zgjedhja e Kryesisë se re dhe drejtuesve të tjerë, përfshi nënkryetarët dhe sekretarët. Mbledhja do të nisë në orën 11:00, ndërsa rreth 270 anëtarë të Këshillit do të votojnë për nënkryetarët, 15 emra që zgjidhen direkt, sekretarin e përgjithshëm, dhe 4 sekretarët funksional.

Pjesë e Kryesisë, janë gjithashtu, kryetarët e organizatave partnere, zëdhënësi i Partisë, si dhe Sekretari për Marrëdhëniet Ndërkombëtare që emërohen nga kryetari i PD-Së. Me këtë moment Partia Demokratike, përmbyll fazën e ristrukturimit të saj, duke u përcaktuar ekzakt që do të ndihmojë Lulzim Bashën në 4 vitet e ardhshme.



Zgjedhjet në PD, të përndjekurit kërkojnë Tomor Alizotin

Vetëm pak ditë nga mbajtja e mbledhjes së Këshillit Kombëtar ku do të bëhen zgjedhjet për forumet e reja drejtuese të PD-së, shoqata e të përndjekurve politikë dhe antikomunistëve kërkojnë përfaqësim. Në një mbledhje të përbashkët të mbajtur gjatë ditës së djeshme shoqatat e të përndjekurve, kanë dalë me një vendim për t'i kërkuar kreut të PD, Lulzim Basha, që Tomor Alizoti të jetë pjesë e strukturave të partisë. Në letërën e tyre drejtuar Bashës, ata kërkojnë që Alizoti të jetë pjesë e lidërshiptit të PD. "Vendosëm unanimisht që t'u drejtohemi juve me besimin e plotë si lidërshipt i së djathtës shqiptare, dhe si vizionar i së ardhmes që në zgjedhjet e forumeve drejtuese të Partisë Demokratike të pranoni që në forumet drejtuese të jetë përfaqësuesi i jonë Anëtar i Këshillit të Partisë Demokratike, si Zv. i juaj, intelektual diplomat dhe pinjoll i një familjeje fisnike shqiptare me kontribut atdhetar që nga shpallja e pavarësisë dhe ndërtimit të shtetit të parë shqiptar, Zotin Tomor Alizoti", thuhet më tej në letërën e drejtuar Bashës.



Drejtori i "Zërit të Amerikës" i përgjigjet akuzave të kryeministrit Rama

"VOA kazan mediatik", Elez Biberaj: "Garantoj vërtetësinë e lajmit"

Gjonaj: "Hedh poshtë akuzat për emërime partiake në Burgje"

Dy ditë më parë "Zëri i Amerikës" (VOA) u vu në shënjestër të sulmeve të kryeministrit Edi Rama, i cili e etiketoi edhe atë si pjesë e klanit mediatik shqiptar. Shkak u bë pikërisht një investigim i hollësishëm e VOA-s ku denoncohej ish-Drejtori i Burgjeve, Arben Çuko, shefja e kabinetit të kryeministrit Rama, Vali Bizhga dhe disa deputetë të tjerë socialistë, në lidhje me punësimet politike në administratën e burgjeve. "Erdhi dita që Zëri i Amerikës të flasë nga kazoni i Tiranës, duke përgjuar dnyjanë mbi bazë llogjesh telefonike. Për herë të parë në Albania organizohet konkurs publik për punësimet në burgje dhe kazoni gjëmon deri në Amerikë e jehon në katundin tonë me-

diatik. Çfarë katandie", - shkroi Rama në dy reagime të njëpasnjëshme rreth këtij investigimi të transmetuar nga VOA. Por një ditë më pas Drejtori për Europën dhe Azinë i Zërit të Amerikës, Elez Biberaj, i është përgjigjur kryeministrit Edi Rama, por duke qartësuar edhe opinionin publik se lajmi i transmetuar ishte i vërtetë.

BIBERAJ

Në një reagim për 'OraNews', Biberaj garanton vërtetësinë e lajmit, ndërsa duke iu përgjigjur Ramës thekson se VOA prodhon gazetari me vlera të paanshme. "Shërbimi shqiptar i Zërit të Amerikës ka siguruar vazhdimisht raportime të sakta dhe të paanshme rreth zhvillimeve në Shqipëri dhe

unë garantoj plotësisht integritetin dhe gjykimin e lajmit. Shërbimi shqiptar vijon me krenari misionin e prodhimit të gazetarisë së vlerave në mbështetje të demokracisë dhe lirisë dhe t'i sigurojë audiencës së tij lajme dhe informacione të sakta, objektive dhe të balancuara në mënyrë që ata të bëjnë zgjedhjet e duhura", - u shpreh Drejtori për Evropën dhe Eurozinë i Zërit të Amerikës, Elez Biberaj. Biberaj garantoj se investigimi për implikimin e deputetëve dhe shefes së kabinetit të kryeministrit shqiptar, në biseda përgjimesh, për punësime, është i saktë ashtu si të gjitha lajmet e publikuara nga kjo media.

GJONAJ

Ndërkohë që në një dalje të posaçme për mediat lidhur me këtë çështje, ministrja e Drejtësisë, prej nga varen burgjet u shpreh se procesi i punësimeve në Drejtorinë e Burgjeve ka qenë i hapur dhe transparent. Ajo hedh poshtë akuzat për emërime partiake në burgje të publikuara nga Zëri i Amerikës. "Hedh poshtë akuzat për emërime partiake në burgje, procesi i punësimeve në burgje ka qenë dhe mbetet procesi më meritokratik. Për herë të parë trajnimi i burgjeve është bërë me Akademinë e burgjeve. Procesi i punësimeve ka qenë u hapur transparent për të gjithë dhe vërtetohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kam dosjen e plotë të gjithë procesit të listës përfundimtare të atyre që kanë fituar", - tha Gjonaj. Denoncimi i Zërit të Amerikës zbuloi se si zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste përdornin vendet e lira të punës në administratën e burgjeve për të punësuar militantët e tyre. Më 30 prill 2018, drejtori i Përgjithshëm në atë kohë i Burgjeve, Arben Çuko mori një telefonatë nga kabinetit i kreut të qeverisë. Biseda bëhej me porosi të drejtoreshës së kabinetit, Vali Bizhga dhe kishte në fokus punësimin e një vajze. Çuko, i cili ndodhej nën përgjim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, piron në bisedë se e kish të firmosur punësimin më herët atë ditë. "Fola me zonjën Bizhga para gjysmë orë dhe i thashë se u fut Vitjona në punë," - citohet të pohojë ai në transkriptin e zbardhur. Ndërkohë që në një pjesë tjetër të këtij përgjimi të zbardhur Çuko bënte të ditur se të gjithë kandidatët e ardhur për t'u punësuar i kishte sjellë partia.



Drejtori për Europën dhe Azinë i Zërit të Amerikës, Elez Biberaj

BIBERAJ

Shërbimi shqiptar vijon me krenari misionin e prodhimit të gazetarisë së vlerave në mbështetje të demokracisë dhe lirisë dhe t'i sigurojë audiencës së tij lajme dhe informacione të sakta, objektive dhe të balancuara në mënyrë që ata të bëjnë zgjedhjet e duhura"

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**SUPPLY OF STAFF UNIFORMS
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: kzoraqi@tirana-airport.com; srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com specifying, request for information for "Supply of staff uniforms".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

This tender will be organized in two phases:

- In the first phase companies will need to present similar works through uniform samples performed for other companies, letter of references and also a sample of the proposed materials.
- In the second phase short listed companies will need to submit their financial offer together with the sample for Tirana International Airport.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **16:00 hrs. on 25 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
kzoraqi@tirana-airport.com
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

Largimet nga puna, shteti ka shpenzuar 102 mln \$ për dëmshpërblim

Shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna shënuan vlera të larta gjatë vitit 2018 në Shqipëri. Zëri i Amerikës i ka bërë sërish dje jehonë një fenomeni negativ që është vënë re në administratën shtetërore dhe që ka të bëjë me paratë që duhet të paguajë buxheti i shtetit për të përballuar detyrimet financiare që lindin nga vendimet gjyqësore për të larguarit nga puna në mënyrë të padrejtë. Duke iu referuar të dhënave të "Open.Spending.Albania", VOA bën me dije se janë rreth 2,595 transaksione të kryera nga janari i 2018 deri në fund të dhjetorit në vlerën e rreth 13,8 milionë dollarëve. Shpenzimet u përkasin institucioneve shtetërore dhe njëvjehtë të qeverisjes vendore dhe u përgjigjen pagesave për zyrtarë që kanë fituar gjyqet pranë Gjykatës Administrative të Apelit të Tiranës për shkarkim të padrejtë nga puna. Viti 2018 shënoi një rënie të lehtë të shpenzimeve për këtë kategori në raport me vitin 2017, gjatë të cilit u shpenzuan rreth 14,4 milionë dollarë. Në pesë vitet e fundit të dhënat flasin se vetëm për shkarkimet e padrejta nga puna nga Ministria e Financave janë paguar mbi 102 milionë dollarë. Rekordin e shënon viti 2014 që pasoi zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 në Shqipëri kur nga Buxheti i Shtetit u paguan për vendimet gjyqësore rreth 32 milionë dollarë.



Ministria e Shëndetësisë: Dokumentacioni dhe kriteret që duhen plotësuar

Nis gara për 220 vende të lira mjekësh në 12 qarqe të vendit

Deri në 31 janar të këtij viti, mjekët e përgjithshëm dhe ata specialistë kanë të drejtë të aplikojnë për vend pune në qendrat shëndetësore. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë ka hapur zyrtarisht garën për rreth 220 vende vakante në 12 qarqe të vendit. Gazeta Shqiptare zbardh sot listat e plota me pozicionet vakante për mjekët specialistë dhe ata të përgjithshëm. "Aplikimi është i hapur për të gjithë mjekët që janë në kërkim të një vendi pune dhe që kanë lejen e ushtrimit të profesionit. Kandidati mund të aplikojë për më shumë se një pozicion", thekson

MSHMS. Kandidatët e interesuar duhet domosdoshmërisht të zotërojnë lejen e ushtrimit të profesionit. Ata duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Shëndetësisë dokumentacionin e kërkuar nga ora 12.00-14.00 çdo ditë të javës.

Përkatësisht mjekët që do të aplikojnë për këto vende të lira duhet të dorëzojnë: kurrikulumin; diplomën universitare dhe listën e notave; diplomën e specializimit (nëse kanë); lejen e ushtrimit të profesionit nga Urdhri i Mjekut; dëshminë e gjuhës së huaj (nëse

kanë); dëshmi/certifikata të kualifikimeve/ trajnimeve në fushën e shëndetësisë si dhe një fotokopje të Librezës së Punës. Ndërkohë për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Në rast se për një pozicion pune paraqitet një kandidat i vetëm, ai do të merret në intervistë për të diskutuar mbi dokumentacionin e paraqitur dhe më pas ministria autorizon direkt drejtorin e qendrës shëndetësore për lidhjen e kontratës së punës me kandi-

datin. "Në rast se për një pozicion pune paraqiten më shumë se një kandidat, atëherë do të organizohet një procedurë konkurrimi me dosje. Për vazhdimin e procedurës kandidatët do të njoftohen me email", thotë më tej Ministria e Shëndetësisë.

VENDET VAKANTE PER MJEKET NE 12 QARQE

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Tiranë

Qarku	Rrethi	Qendra Shëndetësore	Mjek Familje /Specialistë
Tiranë	Tiranë	NR.4	1 pediater
Tiranë	Tiranë	Zall-Bastar	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Tiranë	Peze	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Tiranë	Specialitetet Nr.1	1 Reumatolog
Tiranë	Tiranë	Specialitetet Nr.2	1 Okulist, 1 Kardiologe per eko zemre
Tiranë	Tiranë	Paskuqan	1 Mjek Pediater (Konsultori Femijes)

Vende vakant për Mjek Specialistë në Bashkinë Kavajë

Qarku	Rrethi	Qendra Shëndetësore	Mjek Specialistë
Tiranë	Kavajë	Kavajë	1 Mjek përgjithshëm/ familje
Tiranë	Kavajë	Rrogozhine	1 Mjek Imazherist

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Durrës

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Durrës	Durrës	Nr.4	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Nr.6	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Nr.8	1 Mjek Konsultori Femije
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Obsteter-Gjinekolog
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Endokrinolog
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Imazherist
Durrës	Shijak	Shijak	Mjek Kardiolog, Mjek Neurolog
Durrës	Durrës	Rrushbull	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Katund i Ri	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Gjepalaj	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Ishem	Mjek i përgjithshëm/familje
Durrës	Durrës	Manez	1 Mjek i përgjithshëm/familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Shkodër

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 1	1 Mjek familje 4 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 2	1 Mjek familje 3 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr. 3	2 Mjek familje 3 Pediater
Shkodër	Shkodër	Q.SH Nr.4	1 Mjek familje 3 Pediater 1 Obsteter-Gjinek
Shkodër	Shkodër	Q.SH Gur i Zi	2 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Dajc	1 (nje)MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Postribe	1 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Rrethina	2 (dy) MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Shalë	1 (nje)MPF
Shkodër	Shkodër	Q.SH Velipojë	2 (dy)MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Vau Dejës	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Bushat	2 (dy)MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Vig-Mnele	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Shllak	1 (nje) MPF
Shkodër	Vau Dejës	Q.SH Temal	1 (nje) MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Pukë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Shkodër	Pukë	Q.SH Qafë-Mali	1 (nje) Drejtor/MPF
Shkodër	Pukë	Q.SH Blerim	1 (nje) Drejtor/MPF
Shkodër	Pukë	Q.SH Fierzë	1 (nje) Drejtor/MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Malësi e Madhe

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Grue Mirë	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Kelmend	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Koplik	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Qendër	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Shkrel	1 (nje) Mjek familje
Shkodër	Malësi e Madhe	Q.Sh Kastriot	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Fier

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Fier	Fier	Q SH LEVAN	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH ÇAKRAN	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH FRAKULL	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH PORTEZ	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH NR 3	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH QENDER	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH PATOS	1 Mjek Radilog
Fier	Fier	Q SH KURJAN	1 Mjek Pediater
Fier	Fier	Q.SH Zharrez	1 Mjek Familje
Fier	Fier	Q SH STRUME	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Lushnje

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Fier	Lushnje	Nr1 Lushnje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Allkaj	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Bubullime	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Nr2 Lushnje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Krutje	1 Mjek Familje
Fier	Lushnje	Terbuf	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Mallakastër

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Fier	Mallakaster	Balsh	1 Mjek familje
Fier	Mallakaster	Fratrar	1 Mjek familje
Fier	Mallakaster	Aranitas	1 Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Berat

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Berat	Berat	Nr.3	(2) Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Rroshnik	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Vertop	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Velabisht	(2) Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Sinje	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Otlak	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Lumas	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Posnje	Mjek i përgjithshëm/familje
Berat	Berat	Kutalli	(2) Mjek i përgjithshëm/familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Skrapar

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Berat	Skrapar	Polican	2
Berat	Skrapar	Qender-Potom-Leshnje	1
Berat	Skrapar	Bogove-Vendreshe	1
Berat	Skrapar	Corrovodë	1

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Berat	Kuçovë	Kucovë	2
Berat	Kuçovë	Perondi	2
Berat	Kuçovë	Kozare	1

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Kuçovë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Vlore	Vlore	QSH Nr.1	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSH Nr.2	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.3	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.4	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	QSHNR.5	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	NARTE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	NOVOSELE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	HIMARE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Kote	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	ARMEN	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	VLLAHINE	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Brataj	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Selenice	1 Mjek familje
Vlore	Vlore	Orikum	1 Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Sarandë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Vlore	Sarandë	Sarandë	1 Mjek familje
Vlore	Sarandë	Sarandë	1 Obsteter- Gjinekolog
Vlore	Sarandë	Ksamil	1 Mjek familje
Vlore	Konispol	Xarre	1 Mjek familje
Vlore	Konispol	Markt	1 Mjek familje
Vlore	Finiq	Livadhja	1 Mjek familje
Vlore	Himare	Lukove	1 Mjek familje
Vlore	Finiq	Dhiver	1 Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Gjirokastrë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë	1 Mjek Familje
Gjirokastrë	Dropull	Q.Sh Dropull	1 Mjek Familje
Gjirokastrë	Libohovë	Q.Sh Libohovë	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Tepelene

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Gjirokastrë	Tepelene	Tepelene	1 Mjek Familje
Gjirokastrë	Tepelene	Tepelene	1 Mjek Familje
Gjirokastrë	Memaliaj	Krahës	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Permet

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Gjirokastrë	Permet	Q.SH.Permet	1 (nje) Mjek familje
Gjirokastrë	Kelcyre	Q.SH.Kelcyre	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Elbasan

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Elbasan	Elbasan	QSH Nr.2	2 Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.nr.3	2 Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.nr.4	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Zavaline	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Cerrik	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Cerrik	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Labinot Fushe	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Tregan	1Mjek Familje
Elbasan	Elbasan	Q.Sh.Paper	1Mjek Familje
Elbasan	Gramsh	QSH Lenie	1Mjek Familje
Elbasan	Gramsh	QSH Porocan	1Mjek Familje
Elbasan	Gramsh	QSH Gramsh	1Mjek Familje
Elbasan	Peqin	Q.SH Peqin	1Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Gramsh

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Elbasan	Gramsh	QSH Lenie	1 Mjek Familje
Elbasan	Gramsh	QSH Porocan	1Mjek Familje
Elbasan	Gramsh	QSH Gramsh	1Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Peqin

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Elbasan	Peqin	Q.SH Peqin	1Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Korçë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Korçë	Korçë	Q.SH Rajoni 1	1 (nje) MPF 1 (nje) Mjek Pediatre 1 (nje) Mjek obs- gjin
Korçë	Korçë	Q.SH Rajoni 2	1 (nje) obs-gjin 1 (nje) Pediatre 1 (nje) Mjete Konsultori per Fëmije
Korçë	Korçë	Q.SH Rajoni 3	1 (nje) MPF 1 (nje) Mjek obs- gjin 1 (nje)MPF 1 (nje) Mjek Konsultor I Fëmijeve
Korçë	Korçë	Q.SH Rajoni 4	1 (nje) MPF
Korçë	Maliq	Q.SH Gore	1 (nje) MPF
Korçë	Korçë	Q.SH Drenove	1 (nje)MPF
Korçë	Korçë	Q.SH Voskop	1 (nje) MPF
Korçë	Korçë	Q.SH Lekas	1 (nje) MPF
Korçë	Maliq	Q.SH Pirg	1 (nje)MPF
Korçë	Korçë	Q.SH Bulgarec	1 (nje) MPF
Korçë	Maliq	Q.SH Pojan	1 (nje)MPF
Korçë	Maliq	Q.SH Vreshatas	1 (nje)MPF
Korçë	Maliq	Q.SH Libonik	1 (nje) MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Devoll

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Korçë	Devoll	Bilisht	1 (nje) MPF
Korçë	Devoll	Miras	1 (nje)MPF
Korçë	Devoll	Hocisht	1 (nje) MPF
Korçë	Devoll	Qender Bilisht(Bitincke)	1 (nje) MPF
Korçë	Devoll	Proger	1 (nje) MPF

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Pogradec

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Korçë	Pogradec	Q.Sh Pogradec	1 (nje) Mjek familje
Korçë	Pogradec	Q.Sh Droptisht	1 (nje) Mjek familje
Korçë	Pogradec	Q.Sh Bucimas	1 (nje) Mjek familje
Korçë	Pogradec	Q.Sh Velcan	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Ersekë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Korçë	Ersekë	Q.Sh Ersekë	1 (nje) Mjek familje
Korçë	Ersekë	Q.Sh Leskovik	1 (nje) Mjek Pediatre

Vende vakant për mjek familje/ mjek të përgjithshëm në Rrethin Mat

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Diber	Mat	Xiber	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Klos	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Suc	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Lis	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Derjan	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Macukull	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Komsi	1 Mjek Familje
Diber	Mat	Burrel	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Dibër

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Diber	Diber	Fushe-Cidhen	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Bulqize

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Diber	Bulqize	Qytet	1 (nje) Mjek familje
Diber	Bulqize	Fushe-Bulqize	1 (nje) Mjek familje
Diber	Bulqize	Shupenze	1 (nje) Mjek familje
Diber	Bulqize	Gjorice	1 (nje) Mjek familje
Diber	Bulqize	Ostren	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Kukës

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Kukës	Kukës	QSH Shishtavec	1 Mjek Familje
Kukës	Kukës	QSH Gryke-çaje	1 Mjek Familje
Kukës	Kukës	Qsh Terthore	1 Mjek Familje
Kukës	Kukës	QSH Bicaj	1 Mjek Familje
Kukës	Kukës	QSH Kalis	1 Mjek Familje
Kukës	Kukës	QSH Arrën	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Has

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Kukës	Has	Krume	1 (nje) Mjek familje
Kukës	Has	Golaj	1 (nje) Mjek familje
Kukës	Has	Fajza	1 (nje) Mjek familje
Kukës	Has	Gjinaj	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Tropoje

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Kukës	Tropoje	Tropoje	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Lezhë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Specialisti
Lezhë	Lezhë	Qytet	1 Mjek Familje
Lezhë	Lezhë	Zejmen	1 Mjek Familje
Lezhë	Lezhë	Shenkoll	2 Mjek Familje
Lezhë	Lezhë	Kolsh	1 Mjek Familje
Lezhë	Lezhë	Balldre	1 Mjek Familje
Lezhë	Lezhë	Dajç	1 Mjek Familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Mirditë

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Lezhë	Mirditë	Q.SH. FANE	1 (nje) Mjek familje
Lezhë	Mirditë	Q.SH. KAÇINARE	1 (nje) Mjek familje

Vende vakant për mjek familje/Specialist në Rrethin Kurbin

Qarku	Bashkia	Qendra Shëndetësore	Mjek familje/ Mjek i Përgjithshëm
Lezhë	Kurbin	Mamurras	1 (nje) Mjek familje
Lezhë	Kurbin	Lac	1 (nje) Mjek familje

Studentët nuk tërhiqen, fillon ngujimi edhe në fakultetet e rretheve

Shumë studentë të universiteteve publike në vend vazhdojnë bojkotin e mësimit dhe ngujimin brenda fakulteteve të tyre deri në plotësimin e kërkesave që kanë parashtruar. Aktualisht kësaj forme të protestës i janë bashkuar studentët e Drejtësisë, Ekonomikut, Shkencave Sociale, Shkencave të Natyrës, Filologjikut në UT si dhe ata të Universitetit të Mjekësisë, Bujqëorisë e Politeknikut. Ndërkohë nga konstatimet e kryera ka edhe grupe studentësh që vijojnë normalisht mësimin në Fakultetin e Stomatologjisë. Ditën e djeshme në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minerave është zhvilluar një mbledhje e gjerë mes studentëve e pedagogëve. "Është vendosur për të vazhduar bojkotin, gjë të cilën e kanë mbështetur parimisht edhe pedagogët. Gjithashtu, në vazhdim do të nënshkruhet një petition për shtyrjen e datave të mësimit dhe heqjen e mungesave", thonë studentët. Edhe Asambleja e Stafit Akademik të Fakultetit të Shkencave Sociale ka mbështetur kërkesat e stu-



dentëve dhe ka rishprehur vullnetin e saj për abrogimin e ligjit të arsimit të lartë. "Është hera e parë që në universitetet publike të Republikës së Shqipërisë mblihdet formalisht asambleja e pedagogëve. Thirrja e pedagogëve të FSHS është që të mblihdet të gjitha asambletë e fakulteteve, si dhe një mbledhje e përbashkët e gjithë pedagogëve të Universitetit të Tiranës, për të formalizuar kundërshtimin ndaj ligjit të arsimit të lartë. Sa më shumë të kalojë vendimmarrja nga burokratët dhe anëtarët e mykur të organeve përfaqësuese drejt bashkësisë së pedagogëve dhe studentëve, aq më të dinjitetshme janë vendimet. Studentët u mësuan të gjithëve se demokracia e drejtëpërdrejtë funksionon", bëjnë me dije studentët. Dje edhe studentet e Universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Shkodër, ashtu siç kishin paralajmëruar u janë bashkuar studentëve të Tiranës e Durrisit duke u ngujuar brenda godinës kryesore ku ndodhet Rektorati dhe administrata si dhe disa fakultete, në shenjë proteste për plotësimin e kërkesave të tyre drejtuar qeverisë që në ditët e para të dhjetorit.



VACANCY ANNOUNCEMENT
Project "Countering Serious Crime in the Western Balkans"

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

A. Project Description

The project IPA/2017 "Countering Serious Crime in the Western Balkans" supports since January 2018 the Public Prosecution Offices (PPO's), Ministries of Justice, Ministries of Interior and police in the Western Balkan.

It is financed jointly by the European Commission and the Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ) and implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Italian Ministry of Interior and the Center for International Legal Cooperation (CILC Netherlands).

The project's objective is to raise the effectiveness of and the cooperation among regional and national institutions in fighting serious and organised crime. Combatting illegal migrant smuggling and recovering illegal financial gains obtained through diverse criminal acts are two examples on which the project will focus. Cooperation among investigation institutions of the countries, of the region and of the EU is crucial to improve overall security. Therefore, the project will support the conclusion and realization of cooperation agreements and enhance the use of communication means to better investigate serious and organised crime across borders (for example, through so-called Joint Investigation Teams).

The project is unique in its practical approach. Each country is supported by a prosecutor and a police officer from EU member states as well as lawyers from the respective countries. These so-called embedded country teams advise the partner institutions in their ongoing operations and help them better investigate and prosecute serious and organised crime cases. This approach is advantageous because it allows the partner institutions to receive quick, high quality advice that takes EU best practices into account. In addition, short-term practical trainings on specific issues complement this support and empower police officers and prosecutors with specific capabilities and techniques they need in their daily work.

The project term is: Till March 2020

GIZ office Albania seeks the following staff: Office Manager

B. Responsibilities

The position holder is responsible for:

- Permanent interaction with the ECT/Focal Point for the ECT (EU Prosecutor and Legal Advisor)
- Provide administrative support to the EU Prosecutor in the implementation of area I and IV of the Action;
- Provide administrative support to the Legal Advisor in the implementation of area II and III of the Action.

In this context, the position holder fulfils the following tasks:

C. Tasks

1. Core scope of tasks

- Ensures the strict application of the GIZ rules and regulations;
- Manages the daily accounting and manage both the Cash-book and Bank-book;
- Maintains and administers the GIZ financial systems within the project in accordance with the guidance of the Head of Finance and Administration Officer, GIZ HQ book-keeping and financial controller;
- Efficient processes of all local payments in compliance with GIZ and EU procedures and daily invoice checking, processing and record keeping;
- Liaisons with the GIZ HQ in the country in relation to booking costs and checking invoices;
- Ensures detailed financial records are kept in the formats needed for GIZ internal controlling, internal audits and for EU audits;
- Monitors and regularly reports on the spent and planned resources;
- Communicates with partners of the project;
- Organises events, meetings, conference and trips with the region and to the EU

2. Other duties/additional tasks

The position holder

- Has regular contact to the other project offices in the region;
- Participates in Team Meetings outside the country
- Is capable to work in a sensitive environment

D. Required qualifications, competencies and experience

Qualifications

- Education: Bachelor's degree in economics/business or at least 4 years of relevant professional experience
- Professional Experience: At least 2 years of previous experience in accounting in the context of EU-funded projects
- Languages: Excellent English Language skills
- Organisational skills, experience with organizing events, meetings, conference and trips
- Proficient IT skills (in particular: Word, Excel, SAP)

Contract Conditions:

- Full time employment
- Project office in Tirana
- Assignment period until 31.12.2019

Please forward your application until **27th of January 2019** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

A. Project Background

Within the context of bilateral development cooperation, the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany agreed on the joint implementation of the "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" program (short: ProSEED) in 2016. The overarching aim is to improve the employment situation of the workforce and self-employed, particularly of skilled youth, in the Albanian labor market.

The program currently runs from 01/2017 until 03/2022 and has five components: (i) Technical and Vocational Education and Training (TVET), (ii) Promotion of micro, small and medium-sized enterprises (MSMEs), (iii) Social participation of youth and minorities, (iv) Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment and (v) Promotion of the innovation system.

In 2018 the European Union (EU) contributed funds under the framework of the Instrument for Pre-Accession Assistance 2020 for the Competitiveness and Innovation (C&I) Sector. The delegated agreement based co-financing extended the program by including measures to encourage innovative start-ups and to strengthening a corresponding environment (ecosystem) for start-ups and growing companies. As such, a fifth component (see above) was added to the ProSEED program. The specific objective (outcome) of said component is "to improve the innovative eco-system and boost start-ups creation in Albania". In order to achieve the above-mentioned outcome, the intervention is structured in three Result Areas (RAs), out of which GIZ is responsible for RA1 and RA2. The activities under RA3 (Access to Finance and the Challenge Fund) are implemented by Sida in Tirana. RA1 and RA2 will be implemented within the institutional framework of the GIZ-ProSEED program, but will form an independent, separate structure with regard to objectives, operational planning and staff.

In order to communicate and present the objectives and achievements of this component/project, a Communication and Visibility Plan was agreed between the EU as main donor to the Action and GIZ/Sida as main implementing partners.

Furthermore monitoring of the achieved results of the component/project is key to their delivery. A joint monitoring system on the basis of the project's log frame and the results model will provide information on the state of implementation of the project as well as possible adaptation requirements.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor - Communication and Monitoring

B. Tasks

In the areas of communication and public relations the Advisor performs the following tasks:

- Develops the communication strategy and coordinates the operationalization and implementation of the strategy throughout the project
- Elaborates a social media outreach strategy of the project (including a definition of the target group and indicators of success) and coordinates the operationalization and implementation of the strategy throughout the project
- Maintains and updates the project's Facebook page and any other social media channels used by the project
- Writes PR articles, reports and newflashes on the project activities and achievements for internal and external communication (e.g. success stories)
- Shoots and edits short videos on project activities shown on the project's website, on social media platforms or on other occasions
- Supports layout and creation of fact sheets, roll-ups, poster, standard presentations and other material for the continuous promotion of the project
- Coordinates all communication and visibility activities within the project and with other implementing partners, in particular with Sida, as well as with further organisations involved in the implementation of the project.

All communication materials developed and all activities undertaken shall be in accordance with EU's, GIZ's and Sida's corporate design principles.

In the area of monitoring the Advisor performs the following tasks:

- Acts as focal person for all monitoring related questions within the project team
- Ensures the regular update of monitoring templates in line with EU and GIZ requirements in close collaboration with technical advisors of the projects
- Prepares regular monitoring workshops and supports the implementation of follow up activities.
- Delivers input to the various project reports/publications including annual reports in line with EU/GIZ requirements; contributes to other reports as required
- Sets up the project's knowledge management system and taps into other knowledge management systems

C. Required qualifications, competences and experience:

- Education/training: University qualification in a relevant field (e.g. Journalism, Social Sciences)
- General professional experience: at least 5 years of professional experience in communication management, Media, Journalism or related field
- Languages: Fluent in Albanian, excellent English language skills required (especially written skills)
- Specific professional experience: Experience in journalistic writing and preferably in audio-visual media design, understanding of Monitoring and Evaluation standards and requirements, high creative potential

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project office in Tirana
- Assignment period: until 30.09.2021

Please forward your application until **27th of January 2019** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references. Please include in your application **three work samples** such as written reports, articles or videos (please do not send videos directly but provide links) in English language.

Only short-listed candidates will be contacted or interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 16 Janar 2019 GAZETA SHQIPTARE


"BULEVARDI POLITIK"

- 10 vite miqësi, "zysha" e Partisë Socialiste "lëshon" dorën
- Namik Doklen dhe Sadik Bejkon i ndau politika dhe i bashkoi letërsia
- Ambasadori Soreca nis të eksplorojë restorantet në Shqipëri
- Larg politikës dhe i veshur sportiv, një ditë ndryshe e Berishës

Nuk njihet më Tayna, nuk do ta njihni më me pamjen e re



Eni Koçi fejonet me Genc Prelvukaj? Ja detaji që e vërteton



Nga Armina Mevlani te Zaimina Vasjari, ja ceremonitë që do të bëjnë bujë në 2019



Do martohen apo jo këtë vit? Vip-at që rrëfyan ditën e shumëpritur

Pritej dasmë, por pati ndarje? Çiftet që na thyen zemrën me "divorcin" e tyre

Nga Armina Mevlani te Zaimina Vasjari, ja ceremonitë që do të bëjnë bujë në 2019

Do martohen apo jo këtë vit? Vip-at që rrëfyen ditën e shumëpritur

Pritej dasmë, por pati ndarje? Çiftet që na thyen zemrën me 'divorcin' e tyre

Pamela Aliaj

Viti që kaloi na përfshiu me më tepër momente të bukura ku vip-at tanë kurorëzuan dashurinë e tyre në një ceremoni madhështore me shumë të ftuar. Edhe këtë vit sipas gjasave janë vetëm 4 martesë të sigurta të Vip-ave deri më tani. Edhe pse të themi të drejtën prisnim më tepër, por për fat të keq disa prej tyre ndërruan mendje duke u ndarë apo edhe 'anulluar' dasmën. Më poshtë po ju listojmë disa prej tyre:

ARMINA MEVLANI DHE SHKËLZEN BERISHA

Në 14 tetor të 2018-s çifti shpalli fejesën, ndërsa planet për damsën Armina Mevlani i kishte treguar pak kohë më parë. Ajo është shprehur se ende nuk ka një datë se kur do të mbahet martesë, por do të jetë së shpejti. "Dua një martesë shumë intime, por kam përshlytjen që po e bëjmë nuk do mbetej edhe aq intime duke qenë se jemi personazhe publike", është shprehur blogerja e njohur shqiptare.

ZAIMINA VASJARI DHE KLODIAN ASLLANI

Më 29 janar të vitit që lamë pas Zaimina Vasjari u bë nënë për herë të parë. Ajo dhe bashkëshorti i saj biznesmen Klodian Asllani mirëpritën vogëlushen Khloe 11 muaj më parë. Lidhur me martesën këngëtarja është shprehur se do të mbahet pas lindjes së vogëlushes. "E kemi menduar dhe dasmën, patjetër që do bëjmë, por nuk do të jetë një dasmë tradicionale madje nuk



Stine dhe Graciela



Eni Koçi me Genc Perlvukaj

do të jetë as në Shqipëri... Miqtë dhe familjarët do t'i ftojme në një vend jashtë Shqipërisë. Por nuk po them më shumë", ka thënë Zaimina.

BLERO MUHARREMI DHE AFRONA DIKA

Pas ndarjeve e ribashkimeve, çifti i njohur i shoëbiz-it shqiptar, Blero Muharremi dhe Afrona Dika tashmë kanë vendosur që të kurorëzojnë dashurinë e tyre në martesë. Ka qenë këngëtarja i cili ka zbuluar detaje për kurorëzimin e tyre. Blero ka zbuluar se ceremo-

nia e tyre e martesës do të mbahet më 21 shtator të vitit 2019. Kujtojmë se propozimi i është bërë në një emision në Kosovë, ku Afrona e lumtur tha "PO". Blero ka qenë i martuar më parë me aktoren Teuta Krasniqi, me të cilën ka vajzën Tara.

ERIK LLOSHI DHE ROMINA

Erik Lloshi do të martohet më 17 gusht të vitit 2019 me të fejuarën e tij Romina. Këngëtarja dha lajmin e bukur për një nga mediat rozë nga prapaskena e festivalit

"Kënga Magjike", më 4 dhjetor. E pyetur se si e ka menduar fustanin e bardhë të nusërisë, Romina u shpreh se ende nuk e ka vendosur çfarë nuseje do të jetë. Megjithatë ajo theksoi se është besnike e së thjeshtës dhe i tillë do të jetë edhe look-u i saj në ditën më të rëndësishme të jetës.

MARTESTAT QË PRITESHIN

Samanta Karavella

Ajo vijon të jetë një nga njerëzit publikë më të rezervuar për jetën e saj private dhe gjithmonë

preferon që lajmet lidhur me të t'i japë përmes llogarisë në 'Instagram'. Edhe pse para një viti, Samanta Karavella, u shpreh se do të martohej verën e ardhshme, duket se planet për të veshur vellon e bardhë, këngëtarja bukuroshe i ka shtyrë sërish. Këtë herë Samanta nuk ka treguar afat se kur fansat e saj do ta shikojnë të veshur nuse, por tha që ka hequr dorë nga martesë. Madje, Samanta nuk ka pranuar të pohojë nëse është në ndonjë lidhje serioze, apo jo. E ftuar në



Armina Mevlani dhe Shkelzen Berisha



Blero Muharremi dhe Afrona Dika

Ajo është një nga këngëtares që i pëlqen të eksperimentojë me pamjen e jashtme. Po flasim pikërisht për Taynan, e cila vjen totalisht e shndërruar në bionde këtë herë. Këngëtarja tani më me bujë të madhe në skenë ka publikuar disa fotografi provokuese në llogarinë e saj në rrjetin social "Instagram". Tayna shfaqet me një kostum të kuq gjë që kombinohet me buzët e saj të kuqe. "Kush është kjo dhe çfarë i ka bërë Taynës" ka shkruar Tayna në këtë postim. Ajo duket në formë dhe ndryshimi i saj prej një zeshkaneje në një biondinë ka bërë që Tayna të duket më seksi. Fuqia e një biondeje apo jo?



Nuk njihet më Tayna, nuk do ta njihni më me pamjen e re



Lidhja e papranuar e Eni Koçit dhe Genc Prelvukajt ka qenë shumë e komentuar në media përgjatë gjithë vitit të kaluar dhe më në fund çifti vendosi ta konfirmojë vetëm pak ditë më parë. Por kjo lidhje mesa duket është zyrtarizuar pasi në foton e fundit të postuar në 'Instagram' Eni shfaqet me unazë fejeje. Sigurisht që nuk kanë munguar komentet për këtë unazë, por këngëtarja ka preferuar të mos prononcohet deri tani. Eni dhe Genci aktualisht ndodhen me pushime në Tajlandë ku po shijojnë momentet që po kalojnë së bashku dhe udhëtimet në vendet e ndryshme të ishullit Phuket. Të jetë ky udhëtimi për rastin e fejesës?

Eni Koçi fejohet me Genc Prelvukaj? Ja detaji që e vërteton

emisionin "Wake Up", Samanta tha duke qeshur se edhe fisi i saj ka hequr dorë nga kërkesa për ta martuar, pasi ajo e ka mendjen tek muzika. Edhe pse shpesh herë këngët e saj kanë qenë hite duke arritur majat e suksesit, Samanta nuk ka dhënë detaje për jetën e saj personale. Ajo ka zgjedhur gjithmonë t'i mbajë sekret lidhjet e dashurisë. Kujtojmë se para disa vitesh, ajo u nda nga i dashuri që kishte lidhje prej afro 2-vjeçare. Ndërkohë, para një viti, në media u përhap lajmi se Samanta Karavella, ishte në prag të martesës. Kjo e indinjoi Samantën, e cila i quajti mediat si 'ngatërrestare' dhe ironizoi se do të martohej verën që vinte (2018). Mesa duket u prishën planet edhe këtë herë për dasmë, të presim vitin tjetër tani kur të na i bëjë surprizë!

STINE ME GRACIELEN
Lajmin e ndarjes në atë që faktikisht, duhet të jetë koha më e bukur për familjen, sezonin festiv dhe ndërrimin e viteve, kantautori Ernest Duka (Stine) e dha përmes një postimi prekës në rrjetet sociale, cka tregon se pavarësisht të gjithave, ndjenja e respektit për nënën e fëmijës së tij është e thellë. Por përse nuk pati kurrë një dasmë? Stine, i cituar nga Panorama, ka thënë: "Ka gjëra më të rëndësishme në jetë sesa të mbledhësh 200 vetë dhe t'i tërbosh në dasmën tënde. Atë e bën kur të dojë njeriu. Nuk dua të bëhem tipik çifti formal, që do të martohemi se po vjen në jetë një fëmijë. Do më vinte keq për veten nëse do e bëja këtë. Nëse do e ndiej po, do e bëj një ditë. Por mund ta realizoj kur të bëhet vajza 2 vjeç për shembull.



Erik Lloshi dhe Romina

Do ishte dhe më bukur". Dhe si për ironi, kur vajza iu afrua kësaj moshe, nuk pati martesë, por ndarje me Graciela Pashajn.
ENI KOÇI ME GENC PERLVUKAJ
Megjithatë nuk kanë më asgjë për të fshehur dhe zyrtarisht

kanë pranuar që janë bashkë, sërish Eni dhe Genci nuk u kanë shpëtuar lajmeve të shoëbiz-it. Tani që lidhja është zyrtare, kanë nisur hamendësimet për një ceremoni që, sipas gjasave (lajmeve), do të organizohet këtë vit. Të paktën kështu u shkrua



Zaimina Vasjari dhe Klodian Asllani

në disa media e portale ditët e fundit, por as Eni dhe as Genci nuk kanë konfirmuar asgjë publikisht. Këngëtarja, pak javë më parë, pranoi se është në lidhje me Enin, por nuk tha asgjë më shumë për hapat e mëtejshëm të romancës. Por edhe pse ata nuk flasin, lajmet për ta nuk ndalin. I fundit që qarkulloi këto ditë ishte pikërisht ai për një ceremoni VIP që pritej gjatë këtij viti. Megjithatë, këtë herë foli vetë

Eni duke hedhur poshtë atë që është shkruar së fundmi. Në një story të fundit të saj, këngëtarja, pas lajmit për "një ceremoni VIP" që, me gjasë, shkroi: "Të zotët e punës nuk dinë gjë. Ju, po na e organizuat, vijmë ne. Por ceremonitë nuk i kemi me shumë qejf". Kështu, se ç'kanë në plan, vetëm ata të dy e dinë. Ceremoni, me sa duket, nuk do kemi. Të paktën jo së shpejti dhe jo këtë vit. Eni, kështu tha.

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

10 vite miqësi, "zysha" e Partisë Socialiste "lëshon" dorën

Shoqëria është si vera, sa më shumë kalojnë vitet aq më e mirë bëhet. Dëshmi për këtë është pikërisht shoqëria që kanë arritur të mbajnë 4 gra socialiste, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Ledi Shamku dhe Ermonela Felaj. Të afëruara në PS thuajse në të njëjtën kohë, gjatë kohës që socialistët ishin në opozitë, Hysi, Gjermani, Shamku dhe Felaj u bënë pjesë e Kuvendit të Shqipërisë në të njëjtën legjislaturë. Ndonëse Shamku nuk është më pjesë e jetës parlamentare, të 4 ato kanë arritur që ta ruajnë të fortë shoqërinë, pse jo dhe miqësinë e tyre. E si më e madhe që është ka qenë Vasilika Hysi ajo që është bërë inisiatore për t'u takuar dhe për t'i përcjellë njëra -tjetrës urimet për këtë vit të ri. "10 vjet bashkë, ndaj të merr mall! Rrofsh Lika që na mbloodhe!", - shkruan ish-deputetja, Ledi Shamku teksa ka publikuar një foto nga ky takim.



Namik Doklen dhe Sadik Bejkon i ndau politika dhe i bashkoi letërsia

Ish-deputeti socialist, Namik Dokle prej disa vitesh tashmë është larguar nga politika aktive, ndërsa ka vendosur që t'i kushtohet tërësisht letërsisë. Ai ka arritur që të botojë disa libra, të cilët janë pritur mirë nga lexuesit. Ndonjë prej tyre ai ka mundur që ta vërë edhe në skenë, ndërsa është pjesë dhe e shumë konferencave dhe takimeve letrare, ku edhe ka folur për krijimtarinë e tij. Në këtë kuadër ai ditët e fundit ka qenë në jug të Shqipërisë ku ka folur për librin, ndërsa nuk ka harruar që të fiksojë në foto disa momente të bukura nga natyra e jugut. Një foto ai e ka bërë edhe me poetin tjetër, Sadik Bejko, me të cilin, siç shprehet Dokle, e ndau politika por e bashkoi letërsia. "Me poetin Sadik Bejko. Na ndau politika. Letërsia na bashkoi", shkruan Dokle.



Larg politikës dhe i veshur sportiv, një ditë ndryshe e Berishës

Ish-kryeministri Sali Berisha kaloi një fundjavë ndryshe teksa largoi për pak momente vëmendjen nga politika. Berisha ka ndarë me ndjekësit një foto në 'Facebook', ku shfaqet i veshur sportiv gjatë ecjes. Ish-kryeministri mban të veshur një xhiboks sportiv dhe bie në sy ngjyra blu, identifikuese e Partisë Demokratike. "Në një ecje të gjatë!", shkruan Berisha në dëftiturë.



Ambasadori Soreca nis të eksplorojë restorantet në Shqipëri

Ndonëse ka vetëm pak muaj që është zgjedhur ambasador i Bashkimit Europian në vendin tonë, Luigi Soreca duket se ka filluar ta njohë mjaft mirë Shqipërinë. Së fundmi ai është parë të frekuentojë një restorant të njohur në plazhin e Spilles. Ambasadori, përveç se ka zgjedhur një pamje mbresëlënëse nga deti, ka filluar të njohë dhe vendet ku serviret ushqim i pëlqyer nga të gjithë. Ai është parë i shoqëruar nga një personi tjetër dhe ka konsumuar ushqime, që vetëm italianët dinë t'i shijojnë.

Këshilla

Psikologët e marrëdhënieve në çift kanë renditur një sërë faktorësh, të cilët ndikojnë në marrëdhënien mes dy partnerëve. Fillimi i lidhjes është padyshim si një fushë me lule, por tablosë plot ngjyra, me kalimin e kohës duket sikur i zbehen ngjyrat. E, në fakt, marrëdhënia juaj fillon të çalojë, diku një problem, diku një zënkë, një qejfmbetje, një mospërputhje mendimesh dhe sa hap e mbyll sytë e gjeni veten të mbërthyer, si të zënë në kurth, nga një krizë e pashpjegueshme, së cilës edhe i vini shumë emra, por edhe nuk dini t'i jepni një shpjegim. Psikologët e marrëdhënieve në çift kanë renditur një sërë faktorësh, të cilët ndikojnë në marrëdhënien mes dy partnerëve.

TELEVIZIONI

Nuk ka asnjë dyshim, televizioni vret pasionin. Psikologët këshillojnë se një çift do të duhet me doemos të shmangë një darkë me edicionin e lajmeve në sfond. Një darkë e ngrenë në shoqërinë e folësit të lajmeve, apo kronikave, sigurisht nuk ndihmon në bashkimin tuaj. Por edhe nëse nuk janë lajmet, por thjesht një film, në përfundim të tij mund t'ju ndodhë që të lodhur si jeni, të fini direkt e të mos keni më kohë as për t'u kujdesur për njëri-tjetrin, as të bisedoni me njëri-tjetrin.

MONOTONIA

Ndoshta për pasojë të televizionit, apo për 1 mijë e një arsye, ju keni filluar të hiqni dorë nga shumica e argëtimeve tuaja së bashku, përfshirë edhe mbërthjet jashtë. Ju nuk hani më në restorant jashtë, nuk shkonni më në kinema dhe keni kohë pa kërcyer e defryer në një ambient me muzikë. Tashmë dilni vetëm një herë në javë dhe kjo mundësisht kur ju duhet të takoni miqtë e vjetër, ose kur i ftoni ata në shtëpinë tuaj. Psikologët këshillojnë se kjo fazë është prej atyre që duhet të hiqet qafe shpejt, nëse doni që jeta në çift të vazhdojë. Pasi të keni eliminuar televizionin, mundohuni të bëheni kreativë e të ndizni pasionin mes jush.

KUSHTOJINI KOHË

Jepini fund punës deri në orët e vona të mbrëmjes. Jo vetëm që nuk do të keni kohë për veten, por kështu rrezikoni edhe marrëdhënien me partnerin, duke e vënë durimin e tij në provë. Do t'ju duhet të kuptoni shumë shpejt që puna ka mbërthyer jetën tuaj dhe t'i jepni fund kësaj situatë, para se ajo të fillojë të bëhet objekt debatimesh pafund mes jush. Vendosini vetes si qëllim të mos e kaloni kufirin e 37 orëve maksimumi në një javë në punë. Përpunimi të mbaroni punën herët për të pasur pak kohë para se të hani darkë dhe mundësisht evitoni që këtë kohë ta shpen-



Nga televizioni te xhelozia, cilët janë 10 armiqtë e marrëdhënies në çift

zoni para televizionit.

RREGULLI

Fakti që jeni në një çift dhe që mund të keni vite që njiheni nuk do të thotë që të tregoni parregullësi në disa aspekte të mënyrës së jetesës që bëni. Kështu, evitoni t'i lini gjërat tuaja sa andej këndeje nëpër shtëpi, rregulloni shtratin tuaj, tregoni kujdes për pamjen tuaj të jashtme, edhe pse jeni në shtëpi. Sigurisht që partneri juaj ju do për atë që jeni, por kujdes, sepse pamja e jashtme është gjithsesi e rëndësishme. Duke u kujdesur, i tregoni atij apo asaj që juve ju intereson mënyra se si ai ju sheh, edhe për së jashtmi.

MUNGESA E VËMENDJES

Një tjetër armik i madh i lidhjes suaj është edhe mungesa e vëmendjes. Psikologët bëjnë të ditur se nuk bëhet fjalë për thjesht një vëmendje të castit të tipit dhurimi i një tufile me lule, apo tjetër dhuratat e vogël. Është diçka shumë herë më e thjeshtë se kaq, por shumë më e rëndësishme. Partneri juaj ka nevojë të ndjehet se ju e vëzhgoni, shihni çdo gjë tek ai apo ajo dhe i kushtoni vëmendjen e duhur. Bëni mirë të dini të bëni dallimin e herëve kur ajo shkon tek parukieri apo ai tek berberi. Duhet t'ia vini në dukje tuajse çdo gjë që i rri mirë, që i shkon, që i duket bukur. Komplimentet janë gjithnjë të bukura dhe godasin, ama vetëm kur janë të rënda.

MOS E TEPRONI ME XHELOZINË

Jepini fund vëzhgimeve



alla detektivi 007, kontrolleve dhe stërvitjes së durimit të tij apo të saj nga fakti që jeni gjatë gjithë kohës në kërkim të të fshehtave të tij. Besimi reciprok, sipas shumë psikologëve, është themeli ku ngrihet jeta në çift. Ky është rregulli i artë! Mësojeni dhe kujtojeni vetes gjatë lidhjes, pa harruar, sigurisht edhe të mbani një sy hapur, sido që të jetë, thjesht për siguri.

JETA SEKSUALE

Është pak a shumë si uji për jetën, i domosdoshëm, në raportet në çift. Sigurisht që me kalimin e kohës mund edhe të ndodhë që fantazitë tuaja të mos jenë më aq kulminante, por të bëni në një lloj rutine. Është më se e natyrshe, megjithatë kjo nuk du-

het kurrësi të zgjasë. Duhet të gjeni patjetër mënyrën e duhur për të rindezur pasionin dhe imagjinatën tuaj në krevat. Është një prej pilulave të shëndetshme një lidhje KUJDES ME RAPORTIN ME FAMILJET RECIPROKE

Janë të ditura marrëdhëniet në përgjithësi jo të mira mes nuses dhe nënës së atij, vjehrës, megjithatë, jo më pak, janë edhe marrëdhëniet e tij më nënën, apo babain e asaj. Mos e detroni partnerin të vizitoni pafund prindërit reciprokë e mbi të gjitha tregohuni i vëmendshëm të kuptoni se kur e kaloni cakun. Nuk është ide e mirë që çdo fundjavë të shkonni të drekoni apo



darkoni në një prej familjeve tuaja. Caktoni një masë, bini dakord dhe respektojeni atë. E njëjta gjë vlen edhe për shoqërinë tuaj apo kolegët tuaj të punës. Mos e detroni partnerin tuaj t'i pranojë ata pa dëshirën e tij.

MUNGESA E PROJEKTEVE

Të krijoni një çift, nuk do të thotë vetëm të përballoni të sotmen pa menduar dhe projektuar të nesërmen. Së bashku do t'ju duhet të jeni si një skuadër, e cila lufton për të arritur qëllimet e saj. Filloni me projektet afatshkurtra, të cilat mund të jenë të tipit të pushimeve, blerjes së një makine. Mungesa e planeve së bashku, ju ndan. Në të kundërtën, nëse do të nisni të

projektoni në çift, kjo do t'ju bëjë të ndiheni më të bashkuar dhe do jetë stimul për të ecur përpara, së bashku.

HESHTJA

Mungesa e dialogut paraqet fazën, ndoshta, me negative të një lidhje dhe është një shenjë e qartë që duhet bërë një kthesë e fuqishme, përndryshe lidhja mund edhe të përfundojë. Por mund të ndodhë edhe tjetra; dialogu ekziston, mirëpo asnjëri prej të dyve nuk dëgjon mendimin e tjetrit. Në këtë rast, është absolutisht detyra juaj që të tregoheni jo vetëm të vëmendshëm, por edhe të kuptoni atë se çfarë kërkoni të thotë partneri. Nëse e shihni që vetë nuk ja dilni dot mbanë, atëherë provoni dhe shkonni në ndonjë terapeut për çifte.

INTERVISTA SPECIALE

Dashnor Kaloçi

Historia e panjohur: Me urdhër nga Hysni Kapo na internuan në zona të thella, larg kufirit!

Uran Butka: Në Fierzë, dikush tha të na varnin gurë në qafë dhe të na hidhnin në lumë

Dëshmia: "Ana Petani, karieriste e devotshme ndaj partisë, e ngriti problemin se Merjemja kishte marrë birin e Safet Butkës"

Historian, studiuesi, publicist, shkrimtar, piktor, politikan dhe ish-deputet, Uran Butka, një nga personazhet publike mjaft të njohur pas viteve '90-të, edhe pse mban plot tetë dekada mbi supet e jetës së tij, vazhdon përsëri të punojë, madje me energji të jashtëzakonshme sikur kërkon t'i bëjë sfidë jo vetëm moshës, por edhe gjithë asaj periudhe kohe të errët për të, të para viteve '90-të, kur regjimi komunist ia kishte privuar të drejtën e shkrimeve, studimeve dhe librave, prej të cilave ai thotë se do jenë bashkudhëtarë të tij të pandarë deri në fund të jetës, sa të ketë frymën gjallë. I zhytur mes librave në studion e tij të punës diku në qendër të kryeqytetit pranë Institutit "Lumo Skëndo", që ai drejton prej pak vitesh, duket se ende nuk e ka marrë veten, nga një punë tejet e çmuar për të, madje do të thoshim pa e tepruar edhe një ëndërr e tij, ajo e sjelljes në atdhe të eshtrave të Mithat Frasherit, idhullit të tij dhe njëkohësisht kreut të nacionalizmsë shqiptare. Autor i shumë librave, si atyre me studime të karakterit historik, por dhe lëvrujes i letërsisë me romane dhe libra me tregime, Uran Butka pothuaj nuk ka folur dhe shkruar kurrë për jetën e tij. Kjo është dhe një nga arsyt që na shtynë të takohemi dhe të realizojmë këtë intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", (në tre numra radhazi) por jeta me historitë e tij personale, nuk mund të shkëputet kurrësi nga saga e familjes Butka, të cilët janë quajtur me të drejtë si gurë të fortë e të çmuar e në themelet e historisë shqiptare. Kështu në këtë kontekst, po e fillojmë nga rrënjët e kësaj familje, që është e njohur nga patrioti i madh Sali Butka, për të vazhduar më pas me të birin, Safetin dhe së fundi me atë se çfarë ndodhe me vetë Uranin e familjen e tij gjatë regjimit komunist të Enver Hoxhës?

(vijon nga numri i kaluar)

Zoti Uran, a pati probleme bashkëshortja juaj, Merjemja, që u lidh dhe u martua me djalin e "një armiku të popullit me damkë"?

Po sigurisht. Në spitalin e përgjithshëm, ku Merjemja punonte, Ana Petani, karieriste, që donte të tregojë e devotshme ndaj partisë, e ngriti problemin se Merjemja kishte marrë birin e Safet Butkës dhe ne, me urdhër të sekretarit të Komitetit Qendror të Partisë, Hys-



Uran Butka gjatë një fjalimi në Perurimin e vepres së III të Mithat Frasherit.



ni Kapos, na larguan nga Tirana për të na vendosur larg kufirit dhe qendrave të banuara. Me gjithë presionin e madh, Merjemja nuk pranoi të ndahej nga unë, duke thënë: ku të jete ai, do të jem dhe unë.

Ku ju dërguan pas këtij urdhri "nga lart"?

Fillimisht na çuan në Tropojë e vjetër, por aty ish-

te afër kufirit. Sekretari i Parë i partisë së rrethit iu hakërrua kryetarit të Komitetit, që na kishte vendosur afër kufirit, kur shoku Hysni kishte udhëzuar të na vendosnin larg kufirit dhe larg qendrave, për arsye politike, se unë isha biri i Safet Butkës (shih dokumentet e kryeministrit). Na çuan përkohësisht në Fierzë, gjersa Komisioni i Dëbim-Internimeve me Manush Myftiun në krye, të gjente vendin e duhur. Mirëpo Fierza ishte një qytet i populluar. Në qendrën e edukimit, na bënë diskretimin publik.

Konkretisht, ç'ndodhi me ju aty?

E ngritën më këmbë Merjemjen dhe i thanë: "Pse ke ardhur këtu"? "Më ka sjellë qeveria për të punuar si mjeke", u përgjigj ajo. "Pse nuk tregon të vërtetën"? i

thamë. Vajza gjashtë muajshe në krahë të saj filloi të qajë. "Mbyllja gojën asaj buçeje"- i thanë. Ndërkohë u ngrita unë, ja ku jam unë, çfarë keni me këtë? Unë jam djali i Safet Butkës, që ka qenë antifashist dhe nuk ka vrarë asnjë shqiptar, përveç vetes. U ngrit një drejtor shkollë dhe tha se: ky, more shokë, po na i bën ballistët patriotët! U ngritën dhe disa punëtorë (apo sigurimsa) dhe thanë që t'u varim një gur në qafë dhe t'i hedhim në Drin. Merjemes iu pre dhe qumështi i gjirit në atë moment. U tmerrua. I thashë që të ikë në Tiranë të nëna, sepse mua siç duket do të më arrestojnë...! Mirëpo, një teknik kolonjar i ndershëm, anëtar partie, u ngrit e tha: "Çfarë po bëni kështu? Kjo është familje patriotë, shoku Enver ka folur mirë për Sali Butkën dhe për Gani Butkën". Kështu u shty pak çështja. Sa të zgjidhej, na vendosën në qytetin Bajram Curri.

Po atje si jua trajtuan?

Atje, Merjemen e thirri shefi i policisë dhe i tha që të dorëzonte shtëpinë në Tiranë. Ajo i tha që kishin ardhur provizorist dhe se atje banonte nëna. Polici i tha: "Ke ardhur këtu përgjithmonë dhe këtu do vdesësh!". Ajo u dëshpërua shumë dhe u kthye për në shtëpi e për humbur. Rrugës pyeti një qytetar: "Ku janë varrezat? E kishte humbur mendjen. Natyrisht ishte një tronditje psikologjike për të. Së fundi, Komisioni i Internimeve në Tiranë na degdisi në Martanesh. Na ngulën rrezë Malit të Kapitnës te Teqeja e Baba Fajës, që ishte kthyer në spital. Larg kufirit dhe larg njerëzve, siç kishte urdhëruar shoku Hysni!

Po me punë ku ju stabilizuan në Martanesh?

Merjemes i hoqën specialitetin e nefrologes dhe e bënë mjeke të përgjithshme. Megjithatë si mjeke punoi mirë, e donin martaneshasit dhe i vinin pacientët nga të gjitha anët. Ndërkohë për mua s'kishte vend as në ar-



Në pritje të Papa Jozefit



sim dhe më caktuan llogaritar i këshillit, duke zëvendësuar një njeri me arsim fillor. Ishte synimi për të na tjetërsuar me gjithë familje nga qytetarë dhe profesionistë në katundarë kooperativistë. Kjo gjë zgjati plot për 11 vjet me

radhë. Kur vinim në Tiranë për të parë fëmijët, udhëtonim gjatë dimrit në rrugën e vështirë nga Martaneshi në Krastë, dy orë më këmbë, mandej me makinat e kromit në Bulqizë, Burrel, Laç dhe Tiranë, natyrisht me lejen e Degës së Brendshme. Gjatë verës, dilnim në Bizë më këmbë, duke udhëtuar 3-4 orë, mandej me kamionët e druve, për Shëngjergji dhe Tiranë.

Nisur nga profesioni i vështirë i mjekut, a pati probleme bashkëshortja juaj, Merjemja?

Po, Merjemja ka vuajtur vëcanërisht, madje do të tregoj një ngjarje të saj. Sollen në spital një grua, që kishte



Safet Butka Student

rënë nga dushku, ku priste gjete për bagëtinë. Ishte shtatzënë në muajin e tetë dhe e sollën pa ndjenja aty. Doktorësja bëri gjithçka për ta mbajtur gjallë dhe lajmëroi Burrelin për një helikopter. Nuk ishte e mundur për ta mbartur me kafshë as me barellë. Lajmëroi Tiranën, Ministrinë e Shëndetësisë, mandej kryeministrinë. Ishte situatë e improvizuar "luftë" kundër imperializmit, ndaj nuk mund të nisej helikopteri. Nëna dhe fëmija do të vdesin, përgjegjësia është juaja, u tha Merjemja. Kështu pas ngulimit të saj u detyruan të dërgonin helikopterin, i cili për 10 minuta arriti në maternitetin e Tiranës. Dr. Glozheni tha: "Kur e ka shpëtuar kjo mjeke, atëherë si mos e shpëtojim në". E operuan, dhe u kthye në Martanesh pas 6 muajsh, pasi kishte pësuar frakturë të mëdha. Në klubin e Martaneshit u bë një darkë, u mblodh paria e fshatit. Vetëm dy veta nuk ishin në atë darkë: doktorësja dhe pacientja. Dikur nga mesi i orgjisë, kur i shoqi saj ngriti një gotë: "Shëndeti i doktorësës, që e shpëtoi!", në këtë çast iu sul sekretari i burosë, Azis Kuka dhe tha: "Atë e shpëtoi Partia, jo doktorësja, që është reaksionare!" Kështu filloi një tjetër sulm ndaj nesh, pra, edhe përpjekja për të bërë mirë, kthehej në të kundërtën e saj. Merjemja u sëmur në kushte të vështira dhe u kthye në Tiranë, ndërsa unë qëndrova disa vjet atje, deri në nisjen e Lëvizjeve demokratike të viteve '90-të.

Kur u kthyet në Tiranë, ku punuat fillimisht?

Në Tiranë punova në ndërmarrjen komunale si punëtor, mandej si bojaxhi, lyeja biçikletat dhe bëja stampat e tyre me penel, ishte shumë e vështirë, por arrita ta zotëroj edhe këtë profesion për të mbajtur familjen. Merjemja mbeti pa punë.

Ju kini bërë një pikturë në Martanesh, "Peisazh vjeshhtë", e kini quajtur. Kini pasur kohë e qetësi për të pikturuar?

Kjo pikturë ka një histori. Një ditë të diele, kur nuk pati urgjenca, (sepse unë e shoqëroja mjekun në urgjencat tri-katër orë larg në çdo fshat të Martaneshit), ndaj mora kavaletën, i shkruva bojërat e thara dhe i thashë që do shkoja në pyll për një pikturë. Ajo më tha: Piktërisht sot? Nuk të kujton gjë data i shtator? Jo! i thashë. Ika larg në një vend të pashkelur. Më tërhoqi vëmendjen një trunçu vigan ahu, që po vdiste, ndërsa nga trupi i tij dilte një filiz i ri. Jeta dhe vdekja. U vonova për ta realizuar peizazhin. Merjemja u shqetësua dhe doli me dy tre veta me pishtarë, se atje ishte vend i arinjve. Kur u kthyem, pashë mbi tavolinë një tufë me lule një shënim: "Gëzuar ditëlindjen doktorëshe!" U kujtova. Mora pikturën dhe ia dhurova. Merjemja e ruan atë si një kujtim të bukur të kohëve të vështira. Ndërkohë, ajo shkoi në Ministrinë e Shëndetësisë, që të interesohej për t'u rivendosur në punë,

në një rreth më të afërt. Në atë kohë ishte një zëvendësministër shëndetësisë nga Martaneshi. Ai e priti shumë mirë, se kishte dëgjuar që ishte një mjeke shumë e mirë dhe i tha: "Do të të ndihmoj, por dua që atë pikturën e pyllit të Martaneshit, që më kujton "Pyllin rus" (ai kishte studiuar në Rusi) ta kem unë". Ishte një mitë. Por, Merjemja u revoltua, përplasi derën dhe iku. Kur u ktheva nga Martaneshi, e gjeta me sy të buhavitur dhe më tha: "Nuk e jap atë pikturë, edhe sikur të di që mbetem tërë jetën pa punë".

Si vendosët, pra si vajti fati i asaj pikturë?

U mundova të bëj një kopje të asaj pikturë, por ngjyrat më dilnin të errëta, si gjendja ime shpirtërore. Në një krizë nervore, e hodha kopjen e deformuar nga dritarja. Këto ngjarje të lidhura me jetën e vështirë, por edhe me përvojën, më krijuan një pasuri e jashtëzakonshme, që e kam derdhur te librat e mi.

Përpara se të ndryshonin kohët, pra që po shembet regjimi komunist, a kishit ndonjëherë shpresë që do të ndërronin fatet tuaja?

Unë nuk kisha asnjë shpresë, por Merjemën e mbaja me kurajë dhe ajo shpresonte. Mirëpo erdhën ditët, filloi lëvizja demokratike dhe unë natyrisht që isha pjesë e saj. Në zgjedhjet e 31 korrikut 1991, që fitoi në qytetet e mëdha Partia Demokratike dhe Tomor Malasi, kryetar i Komitetit pluralist të Tiranës më emëroi nëndrejtor të shkollës "Ismail Qemali". Mirëpo kur shkoja në orët e mësimin, nxënësit iknin nga mësimi, të nxitur nga disa mësuës dhe prindër enveristë. "U kthyem Vikingët thoshnin. Gradualisht, duke punuar me një apo dy nxënës, filloi interesimi dhe më pas jo vetëm që vinim me kënaqësi në mësim, por bashkë me ta u bëmë pjesë e ndryshimit.

Në atë kohë ju kandiduat dhe u zgjodhët deputet...?

Po, më pas u zgjodha deputet i Kolonjës dhe kryetar i Komisionit të Mediave dhe

Kulturës për dy legjislacione (1992-'96 dhe 1996-'97). Gjatë këtyre kohëve kam punuar në Parlament për ligjet në fushë të kulturës dhe të mediave, madje realizuam edhe draftin për televizionin publik dhe privat. Ndërkohë, si kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Figurave, kam bërë përpjekje për zbardhjen dhe vlerësimin e qindra figurave të persektuara nga regjimi komunist në Shqipëri dhe Kosovë. Kam botuar disa libra dhe shumë shkrime në shtyp për ta.

Kujtojmë se në atë periudhë, pra në mandatin e parë tuaj si deputet, keni mbajtur disa fjalime të ashpra nga foltorja e parlamentit...?!


Po, në periudhën që isha anëtar i kryesisë së Partisë Demokratike dhe njëherësh deputet në Parlament, kam qenë kritik ndaj regjimit komunist të Enver Hoxhës, kam kërkuar që të dënohej ai juridikisht, si edhe ata që kishin bërë krime, si Shefqet Peçi, Aranit Çela etj, ndërkohë që kam kritikuar edhe publikisht Berishën, për autoritarizëm, trajtjimin e gabuar të pronave dhe të të përndjekurve politikë. Këto kritika janë botuar edhe në shtypin e ditës.

Por pastaj u larguat nga politika, përse...?!

U largova vetë nga politika dhe u mora me studime historike dhe krijimtari letrare. Para tre vjetësh themelua Institutin e Studimeve Historike "Lumo Skendo" në Tiranë, bashkë me Agron Shehaj, biznesmenin e njohur, tashmë deputet i Partisë Demokratike në parlament. Ky institut, përveç hulumtimeve dhe studimeve të ndryshme historike, po boton veprën e plotë të Mid'hat Frashërit në 23 vëllime, një pasuri e jashtëzakonshme e historisë dhe kulturës shqiptare dhe evropiane.

Përveç kësaj, ju personalisht u bëtë dhe iniciatori për sjelljen në atdhe të eshtrave të Mid'hat Frashërit?

Po e vërtetë, Instituti "Lumo Skendo", që unë drejtoj, mori nismën për kthimin e eshtrave të Mid'hat Frashërit nga Nju Yorku, dhe me mbështetjen e qeverisë



Uran Butka dhe Rayerson



Uran Butka gjatë një fjalimi në Kolonjë si deputet

dhe të institucioneve të shtetit shqiptar, u bë e mundur kthimi i eshtrave të tij dhe vendosjen e tyre në panteonin e njerëzve të shquar, pranë vëllezërve Frashëri dhe Faik Konicës. Bustin e Mid'hat Frashërit, që u vendos atje, e realizoi skulptori i mirënjohur Agim Rada. Ndërmjet me fat dhe krenar për këtë investim kombëtar, ashtu si dhjetë vjet më parë, kur si kryetar i Komisionit të Kulturës në parlament mora nismën për kthimin e eshtrave të Faik Konicës dhe bashkë me ministrin Teodor Laço dhe poetin Bardhyl Londo, shkuam në Boston dhe sollëm në atdhe eshtrat e Konicës.

Ju personalisht keni bërë edhe shumë botime historike dhe letrare, a mund të na thoni diçka për to?

Gjatë këtyre viteve kam hulumtuar nëpër arkivat dhe bibliotekat shqiptare e të huaja dhe kam botuar mjaft libra publicistikë dhe historikë, si "Ringjallje", "Lufta civile në Shqipëri 1943-1945", "Masakra e Tivarit", "Marëveshja e Mukjes", "Gjeniu i Kombit", "Kristo Kirka", "Safet Butka", "Bombë në legatën Sovjetike", "Dritëhije

të historisë", "Elita shqiptare", "Kryengritjet e para kundërkomuniste", "E djathta dhe e majta në luftë" e të tjera. Veprat historike i kam botuar nga detyrimi që të ndihmësoj në korrigjimin e historisë së politizuar dhe në vlerësimin historik e të dokumentuar të ngjarjeve dhe personaliteteve kombëtare. Gjithashtu, kam botuar edhe vepra letrare, sepse letërsia është hobi im, liria ime, ajo më buron nga shpirti, dhe është vlerësuar. Janë disa libra me tregime e novela si "Vdekja e bardhë", "Në shtëpinë tonë", "Vetëm një natë", "Humbja nuk është mbarimi", "Më në fund të lirë" dhe romani "Miti i Haxhi Qamilit". Po ashtu kam realizuar mbi 10 filma dokumentarë për ngjarjet dhe personalitetet historike, si "Ventotene", "Sabiha Kasimati", "Musine Kokalari", "Lëvizja Kryeziu", "Mallakstra siç ka qenë", "Kamber Prishta", "Kryengritja e Dibrës 1913", "Lëvizja e Malësisë së Madhe dhe e Postribës" etj.

Ndërkohë ju jeni vlerësuar me mjaft çmime dhe urdhra të rëndësishëm shtetërorë dhe ndërkombëtarë, a mund të na thoni disa prej tyre?

Për mua ka rëndësi puna, ndihmesa dhe gjurma, që të lejëru në jetën e tij.

Opinion i Ditës

Protestat, shpirti i pashuar revolucionar i shqiptarëve dhe domosdoshmëria për institucionalizëm

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... Shqipërisë prej brezit të ri. Shumëkush madje evokoi edhe nostalgjinë e Lëvizjes Studentore, e cila për hir të së vërtetës, është mitizuar e glorifikuar jashtë mase në memoriam kolektive të shoqërisë shqiptare. Në kushtet e një kulture jo të hershme e jo të konsoliduar demokratike, vazhdon të kemi një numër të madh të qytetarëve që kanë iluzionin se revolucionin apo përmbyjsja me dhunë, është arma më e mirë për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri. Kjo magjepsje masive me protestat e studentëve dhe iluzionet e mëdha që u ndërtuar bazuar në to, mund të konsiderohen si dëshmi që njerëzit në Shqipëri ende kanë një preferencë të madhe për radikalizmin, agresivitetin, revolucionin e dhunën përkundrejt gradualizmit, reformave institucionale apo proceseve politike demokratike. Kjo tendencë është padyshim rudiment i trashëguar nga shpëlarja e trurit prej doktrinës komuniste, e cila himnizonte përmbyjsjen e regjimit si mjet të preferuar për të marrë pushtetin. Ende sot dominon në kujtesën tonë historike kolektive një admirim për revolucionin e qershorit të Fan Nolit dhe një urrejtje për lëvizjen e Legalitetit të Zogut që promovonte marrjen e pushtetit me mjete legale. E njëjta tendencë masive e mahnitjes së opinionit publik me protestat u vu re edhe në vitet 2015-17 në Kosovë ku u krijua përshtypja e rremë, tek një segment domethënës i shoqërisë, se protestat e dhunshme me molotov e gaz kinse do i mbyllnin nëherë e mirë plagët e së kaluarës e do ishin "si rrugëdalje për një të ardhme të ndritur". Mirëpo nëse në Kosovë protestave u printe një forcë e majtë me ndikim revolucionar marksist si Lëvizja Vetëvendosje, në Shqipëri mbështetja dhe simpatia për protestat si mjet i preferuar politik po vjen nga një forcë e djathtë që tradicionalisht në Evropë nuk para përgjedh protestat dhe përmbyjsjen si mjet politik.

Përveç ndarjes ideologjike klasike mes atyre që kishin me të shtrenjtë dhe atyre që synonin më së shumti barazinë, historia moderne e Evropës ka pasur një ndarje të madhe edhe për sa i përket mjeteve apo metodave të arritjes së qëllimeve politike të dëshiruara. Pra, përtej ndarjes mes liberalëve që promovojnë ekonominë e lirë të tregut bazuar tek prona private e sipërmarrja në kushtet e konkurrencës dhe socialistëve që dëshirojnë barazinë, ekziston edhe një ndarje tjetër mes revolucionarëve dhe evolucionarëve. Të parët duan ndryshime të shpejta apo të menjëhershme nëpërmjet përmbyjsjes ndërsa të dytët një ndryshim grad-



ual të përmbyjsjes dhe të ngadalshëm, por të qëndrueshëm. Revolucionarizmi i përket kryesisht marksizmit që e shikonte antagonizmin e klasave si pjesë thelbësore të historisë dhe propozonte revolucionin e proletariatit si mjetin e vetëm për të shembur borgjezinë e për të arritur socializmin, që sipas tyre ishte niveli sipëror i organizimit shoqëror ku të gjithë ishin të barabartë.

Në krahun e majtë ishte edhe një rrymë tjetër alternative ndaj revolucionarizmit marksist, ajo e gradualizmit. Kjo alternativë u krijua në Mbretërinë e Bashkuar me Shoqatën Fabian, e cila po ashtu kishte socializmin si objektiv, por mendonte se mund ta arrinte vetëm në mënyrë graduale duke ndryshuar legjislacionin, bërë reforma e ndryshuar kulturën e përgjithshme në atë drejtim. Marksistët avokonin përdorimin e dhunës si mjet për të imponuar diktaturën e proletariatit ndërkohë shumë të majtë të moderuar që u shtuan gjithnjë e më shumë në numër në Evropën Perëndimore,

donin që ndryshimet ti sillnin me mjete paqësore nëpërmjet të drejtës universale të votës dhe procedurës demokratike. Këtu edhe u përçua e majta me forcimin gjithnjë e më shumë të social-demokratëve që shikonin procesin demokratike e jo përmbyjsjen revolucionare si mjet për të arritur qëllimin. Në krahun e djathtë të spektrit politik qëndron konservatorizmi i cili në thelb të tij ka pikërisht konservimin e traditës, vlerave, parimeve, zakoneve, traditave apo institucioneve dhe del kundër ndryshimeve drastike e radikale në shoqëri.

Në Shqipëri është kultivuar tashmë prej vitesh një traditë dhe përshtypje e gabuar, se e vetmja opozitë dinjitoze është ajo ku lideri i opozitës është i gatshëm të shkaktojë dhunë e të mobilizojë protesta masive që tronditin qeverinë. Është bërë, si të thuash, një etalon matës i suksesit të opozitarizmit përmasa e protestës apo dimensionit i dhunës kundër qeverisë. Bazuar në këtë mendim leninist, se fitorja mund të arrihet vetëm

Në Shqipëri është kultivuar tashmë prej vitesh një traditë dhe përshtypje e gabuar, se e vetmja opozitë dinjitoze është ajo ku lideri i opozitës është i gatshëm të shkaktojë dhunë e të mobilizojë protesta masive që tronditin qeverinë. Është bërë, si të thuash, një etalon matës i suksesit të opozitarizmit përmasa e protestës apo dimensionit i dhunës kundër qeverisë.

nëpërmjet përmbyjsjes, lideri i opozitës së Shqipërisë, Luzlim Basha, konsiderohet opozitar i dobët. Ajo që e bën akoma më qesharake situatën është se edhe brenda të djathtës, e vetmja alternativë kritike që i vjen Bashës, po artikulohej nga një pjesë ish-titullarësh të PD-së, të cilët e qortojnë me qasje leniniste e ai nuk është mjaftueshëm i ashpër e i egër ndaj qeverisë, pra jo aq revolucionar sa duhet. Thënë ndryshe lideri i të djathtës po kritikohet se nuk është mjaftueshëm ihtar i marksizmit-leninist për sa i përket shpirtit revolucionar dhe përdorimit të përmbyjsjes me dhunë për t'i ardhur hak qeverisë. Në një situatë normale evropiane kritika kryesore do të duhej të bëhej për mosparaqitjen e një vizioni të qartë e të besueshëm programor të alternativës për të ardhmen, për paafësinë për të krijuar një epërsi morale përkundrejt mazhorancës, për paafësinë për të rekrutuar kadro të rinj të pakomprometuar e me nivel të lartë profesionalizmi, mungesa e reflektimit dhe autokritikës për abuzimet dhe dështimet e shumta të qeverisjes së kaluar që qenë shkaktarë të vërtetë të rotacionit etj. etj. Por kurrsesi pse nuk arrin të organizojë protesta masive apo pse nuk është mjaftueshëm revolucionar i dhunshëm si lider i djathtë.

Kjo lloj lidhje romantike që kanë shqiptarët me revolucionarizmin e dhunës si mjet politik i parapëlqyer të kujton, gjithashtu, në njëfarë mënyre lidhjen mes dëshpërimit dhe lojërave të fatit. Një ndër fenomenet më interesante për sjelljen konsumatore që

studiohet në shkencat sociale është lidhja e ngushtë shkak pasojë mes varfërisë dhe lojërave të fatit. Edhe pse kazinoja, bixhozi, kumari apo lotaria konsiderohen në pamje të parë si lojëra lukse për ata që kanë para për të hedhur, analizat empirike nxjerrin se pjesa më e varfër e shoqërisë është ajo që më masivisht angazhohet në lojërat e fatit. Argumenti që mbizotëron për të shpjeguar këtë fenomen, është se, edhe pse kundërintuitiv e jo logjik, ata që janë më të dëshpëruar kërkojnë, gjithashtu, zgjidhje të dëshpëruara. Pra, sa më në gjendje të depresionuar të jenë aq më shumë janë të prirur që të varin shpresat tek një zgjidhje finale, radikale, të shpejtë e të prerë sikurse është fitorja e milionave në lotari apo bingo. Në kushte ekstreme, në njëfarë mënyre njerëzit dorëzohen e nuk besojnë më tek zgjidhjet konvencionale, graduale e të natyrshme, por ushqejnë një iluzion se përmirësimi do të vijë i befte si me shkop magjik. Kjo gjendje e skajshme skamnore me sa duket i shtyn të shprehin se problemet e tyre iu vjen fundi vetëm me lojëra të fatit. Kjo sepse sipas tyre, fundja nuk është se kanë shumë për të humbur, përveç ndonjë bilete lotarie, ama shpërblimi është tejet i madh. Me fjalë të tjera më të dëshpëruar, nuk mendojnë se mund të dalin nga varfëria nëpërmjet punës, sipërmarrjes, arsimit, talentit, durimit, këmbënguljes, por nëpërmjet fatit.

Lidhja mes dëshpërimit dhe lojërave të fatit në sjelljen ekonomike të qytetarëve po shikohet se është gjithnjë e më e ngjashme edhe me sjelljen elektorale të tyre. Vitet e fundit kanë dëshmuar se jo vetëm mes shqiptarëve, por anëmbanë botës së zhvilluar, ka një tendencë dëshpërimit e dorëzimi me sistemin aktual dhe eksperimentimi me nisma politike jokonvencionale. Profesionit i politikës dhe proceset demokratike konvencionale kanë humbur besimin në syrin e publikut të zhgënjyer me establishmentin aktual në politik. Në kushtet të tilla ekstreme të mosbesimit në demokracinë liberale edhe zgjidhjet po kërkohen tek alternativa politike ekstreme. Për rrjedhojë, anëmbanë Evropës, janë ndërtuar e konsoliduar forca politike populiste, të ekstremit të majtë e të djathtë, të cilat kanë një ofertë politike që i shkon përshat kësjaj prirjeje në elektoratin skeptik, cinik apo pesimist. Franca është në dorë të lideri karizmatik populiste, i cili më pas ndiqet nga një tjetër lidere ekstremiste e djathtë populiste si Le Pen me Frontin Nacional. Ndërkohë që golistë dhe socialistë janë lënë prapa skene në politikë. Në Itali po ashtu kemi marrjen e pushtetit nga Cinque Stelle dhe Lega Nord ndërkohë që →

Dje në "Deutsche Welle"

Maqedoni, çfarë ndryshon me zyrtarizimin e gjuhës shqipe?

Nga Fatos Musliu

(vijon nga faqja 1)

... e pushtetit gjyqësor, administratës publike si dhe ndërmarrje e institucione tjera. Me këtë ligj drejtuesit e seancave, goftë të Qeverisë apo Kuvendit, nëse janë shqiptarë, ato do të mund t'i udhëheqin në gjuhën e tyre, ndërsa të gjitha aktet botohen edhe në gjuhën shqipe. Mbishkrimet në nivel qendror do të jenë në dy gjuhë. Gjithashtu me këtë ligj parashihet që uniformat e policisë, të zjarrfikësve dhe të punonjësve shëndetësorë të jenë edhe në gjuhën shqipe në Shkup dhe komunat, ku mbi 20 për qind e popullatës janë shqiptarë.

Për zbatimin e ligjit për gjuhët do të jenë përgjegjëse Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve dhe Inspektoriatit për Përdorimin e Gjuhëve. Për moszbatim të ligjit janë paraparë edhe gjoba për institucionet nga 4 deri në 5 mijë euro. Gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, të gjitha institucionet në Maqedoni janë të obliguara t'i zbatojnë obligimet e ligjit.

XHAFERI: OBLIGIM TË RESPEKTOJ KUSHTETUTËN

Kreu i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi e nënshkroi të martën ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili tanimë u botua edhe në Gazetën Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi. E kam ndërmarrë këtë vep-



rim, pasi prita një vit kreun e shtetit, ka thënë Xhaferi. "Për faktin se ai nuk pranoi të zbatojë obligimet e tij është kompetencë dhe obligim i mi që unë që respektoj kushtetutën dhe ligjet që ka miratuar Kuvendi dhe me vullnetin t'i vë në veprim dhe me këtë vlerësoj se kam zbatuar kompetencat e mia kushtetuese", ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Talat Xhaferi.

REAGIME TË ASHPRA

Vendimi për përdorimin e gjuhës shqipe në Gazetën Zyrtare është publikuar pa nënshkrimin e presidentit maqedonas Gjorgji Ivanov. Ai e ka shpërfillur në vazhdimësi të dekretoj ligjin në fjalë. "Publikimi i ligjit për gjuhët në Gazetën Zyrtare ka mundësuar që të shohim fytyrën e vërtetë të ko-

alicionit qeveritar LSDM-BDI, kolacion që veten e quan pro-evropian. Shpallja e ligjit për gjuhët në Gazetën Zyrtare dhe e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës, pa dekreton e Presidentit, është jo-kushtetuese. Kjo paraqet bazë për ndjekje penale", thuhet në reagimin me shkrim të presidentit Gjorge Ivanov.

Ndërsa VMRO-DPMNE-ja opozitare publikimin e ligjit në gazetën zyrtare e vlerëson si akt të dhunimit të demokracisë. "Përgjegjësinë për botimin e ligjit pa firmën e Ivanovit e mban Martin Kostovski, drejtor i Gazetës Zyrtare dhe të gjithë të involvuarit e tjerë. Me këtë akt LSDM-ja sërish ka dhunuar demokracinë dhe ka shkelur rendin kushtetues në Maqedoni", thuhet në reagimin e

VMRO-DPNE-së. GRUBI: MË LIGJIN PËR GJUHËT REALIZOHET TËRËSISHT MARRËVESHJA E OHRIT

Për deputetin e BDI-së, Artan Grubi zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Maqedoni rrumbullakëson tërësisht Marrëveshjen e Ohrit. "Më në fund arritën të zbatojmë pjesën normative të Marrëveshjes së Ohrit, me ç'rast aritëm barazinë gjuhësore në Maqedoni në përputhje me kushtetutën dhe me premtimet tona programore. Shoqëria jonë po bëhet më e fuqishme, më kohezive, më e integruar dhe më evropiane", vlerëson Artan Grubi nga BDI. Ndërsa profesori i së drejtës kushtetuese Temelko Risteovski vlerëson se vendimi i kryeparlamentarit Xhaferi për publikimin e Ligjit për gjuhët në Gazetën Zyrtare është i drejtë dhe nuk ka të bëjë me shkeljen e kushtetutës. "Në rastin konkret, presidenti i Republikës me mosrespektimin e normës kushtetuese për nënshkrimin e ligjit pas votimit të dytë në Kuvend, ka bërë shkelje të aktit më të lartë juridik në vend. Presidenti në bazë të Kushtetutës një herë ka të drejtë të mos dekretoj ligjet, por nëse i njëjti ligj votohet sërish në Kuvend, atëherë kushtetuta e obligon atë të nënshkruajë ligjin", thotë Temelko Risteovski.

demokristianët e socialistët tradicionalë janë në hije. Greqia po qeveriset nga Syriza ndërsa Nea Demokratia e Socialistët janë jashtë pushtetit. E njëjta tendencë mund të shihet edhe në vendet të tjera me radhë të botës demokratike. E thënë ndryshe po shtohet po shtohet numri i votuesve që mendojnë "se këta politikanët që kemi, i njohim mirë e s'kemi ndonjë iluzion ndaj tyre, përse mos të eksperimentojmë me aktorë të rinj që mund të sjellin ndonjë ndryshim, s'kemi çfarë të humbasim".

Në përgjithësi përvojat me pasoja të rënda të revolucioneve që kanë ndodhur dhe shumë krimeve mizore të bëra në emër të revolucioneve, kanë bërë që pjesa më e madhe e shoqërive të avancuara të zgjedhë evolucionin si rrugën më të mirë për të ecur përpara. Pra, janë dëshmuar me shumë në favor të reformave institucionale e gradualizimi përkundër ndryshimeve të bëta radikale të paparashikueshme që ngelen në dorë të fatit. Shtetet moderne dhe shoqëritë e zhvilluara funksionojnë nëpërmjet institucioneve e procedurave demokratike e jo rastësisë apo iluzioneve ndërkohë që kanë ndër vlerat kryesore stabilitetin e

parashikueshmërinë të mbështetur në një tërësi të rregullave dhe e normave juridike. Shtetet e shoqëritë e prapambetura dallohen pikërisht nga tipare si mungesa e stabilitetit, veprimeve ad-hoc, improvizimeve politike, qëndrime e veprime impulsive të kushtëzuara nga rrethanat si dhe tendenca tipike, si paparashikueshmëria e dhuna.

Zhëngjimi më i freskët dhe i preکشëm me revolucionet është padyshim zhëngjimi me pranverën arabe apo të ashtuquajturin "revolucionin i jasemintë" që nisi në vitin 2010. Shpresa ose më saktë iluzioni që u krijua për një përmbytje të shpejtë të regjimeve të kalbura arabe dhe zëvendësimi i tyre me demokraci funksionale shpejt u zbeh pasi shoqëritë që nisën protestat në botën arabe e gjetën vetën të binin nga shiu në breshër. Sot vazhdon të kemi luftë civile në Siri, Libi, Irak e Jemen. Egjipti vazhdon të ketë një regjim ushtarak e ndërkohë nuk pati ndonjë ndryshim thelbësor në shtetet e tjera që u prekën nga vala e "pranverës arabe" me përjashtim deri diku të Tunizisë. Mirëpo nuk ka nevojë për të shkuar shumë larg në hapësirë për ta kuptuar se sa i dëmshëm mund të jetë iluzioni i ndryshimeve

radikale revolucionare. Mjafton të kthehemi dy dekada prapa në historinë bashkëkohore të Republikës së Shqipërisë, në vitin e mbrapshtë 1997. Në atëbotë marazi e agresiviteti i turmave çoi në një shkëmbim të shtetit si me pas qenë kalë rëre, dhe nuk zgjati shumë por vendin e kaploi anarkia totale. Të njëjtët njerëz që kishin goditur policinë me gurë e çka do të kapnin në dorë në fillim të vitit 1997 ishin të dëshpëruar që të rishikonin kthimin e uniformave blu pas terrorit që shkaktuan bandat e kriminelëve që vepronin pa iu hyrë gjemb në këmbë. Madje mund të hamendësohet se protesta jo-partiake po organizohen nga të rinj studentë sot pikërisht se ata nuk e kanë përjetuar e nuk iu ka ngordhur nervi i protestës prej viteve të turbullta 1997-98.

Pa dashur që të tepochet pa masë me histori, thelbi është që historia ka dëshmuar se rruga e duhur drejt progresit dhe mirëqenies nuk është rruga e rrugës, rruga e përmbyesjes së dhunshme apo protestave por rruga e institucionalizimit, e procedurave demokratike dhe e ligjit. Nëse përmbyesja ishte e kuptueshme dhe e pritshme për Republikën e Shqipërisë në vitin 1997 pak vite pas rënies së diktaturës më të

egër e më të izoluar të Evropës, është e papranueshme që të shikohet si rrugëdalje apo mjeti i preferuar politik më shumë se dy dekada më pas. E njëjta gjë vlen edhe për Kosovën. Ne kemi nevojë të ndërtojmë institucione të qëndrueshme demokratike të bazuara mbi ligjin dhe kur flasim për institucione, nuk duhet patur parasysh ndërtesa madhështore por për jetën institucionale. Pra, forcimi i institucioneve demokratike nënkupton një qasje të mirëfilltë institucionale dhe këtu bëhet fjalë për zakonet, traditat, rutinat, përvojat e ripërsëritura, konstitucionalizëm dhe rrugë ligjore, rregullat e qëndrueshme e të pandryshueshme, parimet themelore të palëkundura, praktikat standarde, proceset periodike si zgjedhjet e lira e të ndershme. Ka ardhur koha që shqiptarët kudo që janë t'i thonë boll e mos të vënë më bast, improvizimeve, agresivitetit, instabilitetit duke hequr dorë nga magjepsia për ndryshimet revolucionare radikale e përmbyesjet e dhunshme e tek ndryshimet e shpejta fatlume, por të qëndrojnë me këmbë në tokë në kuadër të normalitetit, institucionalizmit e gradualizimit.

HOROSKOPI

DASHI

Do të keni shansin të përjetoni një surprizë shumë të këndshme. Bëni shumë kujdes në punë, kontrolloni emocionet dhe ruani qetësinë. Duke vepruar kështu do të mund të arrini një rezultat shumë të mirë. Në mbrëmje mos nixtoni për të bërë bierje spontane.

DEMI

Personat e kësaj shenje do të jenë me shumë fat gjatë ditës së sotme. Një marrëdhënie dashurore që konsiderohet e pasigureshme do të rinisë dhe situata financiare do të përmirësohet. Përshatuni rrethana dhe respektoni njerëzit rreth jush.

BINJAKET

Binjakët do të vënë në punë fantazinë sot. Faktet do tju ndihmojnë të krijoni një figurë të qartë për gjithçka që ndodh në karrierën tuaj apo fatin personal. Intuita do të këmbëngulë për të kundërtën. Gjithashtu, nuk rekomandohet të dëgjoni këshillat e të afërmeve, mëqë ato kolegjive.

GAFORJA

Gaforet duhet të heshtin dhe jo të shprehin përpara një personi të rëndësishëm, pasi ka gjasa që të vendosë rrugën tuaj të jetës. Një çështje e veçantë do të kërkojë vëmendjen tuaj maksimale në mbrëmje.

LUANI

Të lindurit e kësaj shenje nuk kanë gjasa t'i shpëtojnë nxehtësisë së pasionit. Mund të keni mosmarrëveshje me një familjar. Beqarët e kësaj shenje duhet të bëjnë shumë kujdes me fjalët drejt seksit të kundërt.

VIRGJERESHA

Nuk rekomandohet të bëni plane afatgjata. Kjo ditë mund të jetë pikë ktheese për shumë prej jush. Pasdite do të kuptoni se çfarë ndryshimesh do tju ndodhin. Ndërkohë, përpiquni të ruani qetësinë dhe të vlerësoni situatën se çfarë po ndodh.

PESHORJA

Peshoret mund të japin një kontribut të rëndësishëm sot për të ardhmen e tyre. Mund të jepni disa ide brilante në punë. Gjithashtu, ka gjasa të arrini një marrëveshje biznesi. Fati do tju ndjekë gjatë gjithë ditës.

AKREPI

Personat e kësaj shenje duhet të merren me diçka të re sot. Për shkak të mungesës së eksperiencës, rezultati do të jetë e kundërta e asaj çfarë ju rrisin. Është e rëndësishme të ruani objektivitetin juo vetëm ndaj vetes, por edhe ndaj të afërmeve tuaj.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të jenë të qetë gjatë paradites. Por bëni kujdes pasdite pasi mund të tensionoheni për çështje të vogla, të cilat do të ndikojnë në mënyrë direkte në humorin tuaj. Nëse keni në plan diçka argëtuese për në mbrëmje, do të bënit shumë mirë të mos anuloni.

BRICJAPI

Entuziazmi juaj mund të shkatërrojë marrëdhënien me një person shumë të dashur. Megjithatë mos u trishtoni. Vazhdoni të ecni përpara dhe të realizoni planet tuaja. Përpiqu të bësh diçka që tju lumturtojë, pasi është shumë e rëndësishme.

UJORI

Do të keni sukses gjatë ditës së sotme, veçanërisht lidhjen tuaj romantike. Kjo e mërkurë nuk është dita e duhur që të nisni të zbatoni idetë e reja. Nëse kërkoni ndryshime, nisni të ndryshoni arredimin e shpëtisë ose stilin tuaj të veshjes.

PESHQIT

Peshqit sot nuk do të jenë personat më të këndshëm të mundshëm. Madje ka gjasa të bëheni shumë pesimist. Bëni kujdes kur flisni me të tjerët, kontrolloni fjalët, pasi mund të lëndoni personat rreth jush.

Duket qesharake, por është e vërtetë! Anulohet shitja e Latif Amadu te Shakhtyor Soligorsk në kampionatin bjellorus. Pak ditë më parë klubi bregdetar njoftoi transferimin e sulmuesit në skuadrën ku luan edhe Elis Bakaj, por ky transferim ka dështuar. Pas arritjes së gjetjes së akordit për çmimin prej 150 mijë eurosh, kanë qenë përkufizimi i detajeve si dhe një devijim i rëndësishëm i Soligorsk në akordin për kushtet personale me Latif që ka hedhur në erë transferimin. Pikë së pari, mënyra e kryerjes së pagesës, Shakhtyor Soligorsk ka paraqitur pretendime për pagesën prej 150 mijë dollarësh me këste duke vonuar kryerjen e saj deri në vitin 2020 çka është konsideruar e papranueshme nga drejtuesit e klubit durrsak. Veç të tjerash po kaq i rëndësishëm ishte dhe fakti se edhe kushtet e ofruara në termat personale për Latif kanë pësuar një ndryshim rrënjësor duke qenë se bjellor-

tet personale me Latif që ka hedhur në erë transferimin. Pikë së pari, mënyra e kryerjes së pagesës, Shakhtyor Soligorsk ka paraqitur pretendime për pagesën prej 150 mijë dollarësh me këste duke vonuar kryerjen e saj deri në vitin 2020 çka është konsideruar e papranueshme nga drejtuesit e klubit durrsak. Veç të tjerash po kaq i rëndësishëm ishte dhe fakti se edhe kushtet e ofruara në termat personale për Latif kanë pësuar një ndryshim rrënjësor duke qenë se bjellor-

Teuta refuzon kushtet qesharake

Bjellorusët e "dredhin", duan të paguajnë me këste dhe ulin pagën e lojtarit

usët tentuan të përgjysmonin pagën e futbollistit ganez çka i ka vënë vulën vendimit të Teutës dhe Latif që futbollisti të kthehet në Durrës. Në këtë mënyrë mund të thuhet se është Latif blerja e Teutës në sezonin e dimrit, klubi breg-

detar ishte përgatitur për të shpenzuar një shumë të konsiderueshme për të afruar një sulmues klasi me pagë tepër të lartë në merkaton e janarit, por me kthimin e Latif tanimë diçka e tillë mund të konsiderohet e panevojshme. Kryego-

lashënues i kampionatit me 9 gola në gjysmën e parë të tij, tanimë 25-vjeçari nga Gana rikthehet nën urdhrat e Bledi Shkëmbit dhe njëkohësisht në një problem më shumë për mbrojtjet kundërshtarë.

Piatek-Milan, thuaje e mbyllur!

Kristof Piatek është shumë pranë transferimit të Milani. Presidenti i Xhenoas, Enriko Preciozi i ka ndezur dritën jeshile transferimit të sulmuesit polak te kuqezinjët në këtë sesion merkatoje. Do të jetë pikërisht golashënuesi i dytë më i mirë i këtij kampionati dhe surpriza e vërtetë e sezonit në Serie A, zëvendësuesi i Gonzalo Higuain te Milani. Përveç se për afrimin e Piatek për të cilin po punon personalisht Leonardo drejtuesit e tjerë të klubit kuqezij Maldini dhe Gazidis do të flasin në Arabinë Saudite me drejtuesit e Juves për të bërë të mundur edhe transferimin e Higuain te Çelsi. 23-vjeçari Piatek autori i 13 golave në kampionat dhe i 19 golave në total me Genoa në këtë sezon do të transferohet te Milani në formë huazimi me detyrim blerjeje nga ana e klubit kuqezij verë e ardhshme për një shifër të përafërt me 40 milionë euro.

Levante dhe zviceranët gjejnë gjuhën e përbashkët. Sulmuesi mund të rikthehet në Spanjë në verë



Jeton Selimi

Sadiku huazohet te Lugano fati i keq përndjek Mavrajn

Mbrojtësi thyen dorën në stërvitje, operohet

Armando Sadiku kthehet te Lugano në Su perligën e Zvicrës, ekip ku luajti për herë të fundit në elitën e futbollit helvet para se të niste aventurën te Legia e Varshavës në Poloni e më pas te Levante në Spanjë. Sulmuesi i Kombëtares Shqiptare ka kaluar me sukses testet fizike këtë të hënë në praninë e mjekëve të klubit të tij, Levantes, duke u transferuar në formë huazimi tek ekipi zviceran deri në fund të sezonit, me të drejtën e blerjes së kartonit. Presidenti i Luganos, Enzo Renzetti, u shpreh i lumtur për këtë marrëveshje, duke qenë i bindur se pavarësisht se vjen nga një dëmtim i rëndë, Sadiku mbetet më i fortë se të gjithë sulmuesit që ka aktualisht në skuadrën e tij. "Problemi i vetëm është se Sadiku nuk ka zhvilluar ndeshje zyrtare në këtë sezon. Gjithësesi, kam folur personalisht me djalin. Është shumë i motivuar dhe po pret me padurim që të na bashkohet." Levante nuk e huazonte dot sulmuesin dhe e ka gjetur zgjidhjen, duke e shitur te Lugano. Sekretit është një klauzulë në kontratën e bërë



mes klubeve. Spanjollët kanë të drejtë ta blejnë në verë. Sigurisht që shuma do jetë simbolike, pasi kartoni i sulmuesit është i Le-

vantes, që ka shpenzuar plot 1 milion euro. Te Lugano Sadiku ka luajtur edhe në dy periudha të tjera. Për herë të parë iu bashkua në

vitin 2012 dhe në Challenge League ai arriti të realizonte plot 18 gola, çka bëri që Zyrihu ta blinte me pas. Lugano është kthyer

në një klub rehabilitimi për sulmuesin. Pas një dëmtimi te Zurich, ai rimori veten aty në pjesën e dytë të sezonit 2016-2017. Plot nëntë gola të realizuar dhe më pas erdhi shitja te Legia e Varshavës në Poloni. Sulmuesi i kombëtares ka mundësinë të luajë dhe të rikthehet në nivele të larta. Mërgim Mavraj duket se po përjeton një nga periudhat më të pafat të karrierës së tij futbollistike. Kapiteni i përfaqësueses shqiptare duket se do të rigjente veten me kthimin te Ingolsh-tad, pas eksperiencave jo shumë të lumtura te Hamburg e Aris. Por edhe kjo në Gjermani ka filluar shumë keq, pasi ai është dëmtuar rëndë që në fillimin e stërvitjeve. Sipas informacioneve të bërë publike nga vetë klubi, Mavraj është rrëzuar dhe ka pësuar një frakturë serioze në dorë që e ka detyruar jo vetëm të lërë

stërvitjen, por edhe të shkojë me urgjencë në spital për t'iu nënshtruar ekzaminimeve mjekësore. Atje është konstatuar se lojtari duhet t'iu nënshtrorë një ndërhyrje kirurgjikale e cila është mbyllur me sukses. Klubi nuk ka bërë të ditur se kur është parashikuar kthimi i tij në stërvitje, por ka siguruar se gjithçka ka shkuar mirë dhe pret që Mavraj si zakonisht të kthehet shpejt në fushën e lojës. "32-vjeçari është mirë dhe ata që e njohin ekspertin e mbrojtjes apo që e kanë takuar në këtë periudhë të shkurtër te Ingolsh-tad, e dinë se do të presin një kthim të shpejtë të tij në skuadër", shkruhej në faqen e klubit.

Në vigjilje të sfidës ndaj Milanit e vlefshme për Superkupën e Italisë që do të vendosë edhe fatet e trofeut të parë për vitin 2019, trajneri i bardhezinjve Massimiliano Allegri rezervon disa këshilla për të tjihtë. "Sigurisht që ajo ndaj Milanit për Superkupën do të jetë një ndeshje e madhe. Do të përpiqemi të çojmë në shtëpi trofeun që na mungon prej dy sezonesh. Në një ndeshje të tillë diferen-cat e pikëve mes dhe Milanit dhe Juventusit në kampionat zbehen dhe një triumf hipotetik i kuqezinjve ndaj Juventusit do të nënkuptonte rritjen e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit tek organika e Gatzos, pasi të arrish një trofe si ky nuk është pak. Në këtë kontekst për sfidën e së mërkurës do

Bardhezinjtë duan trofeun e parë të vitit 2019

Alegri: Rikthejmë në shtëpi Superkupën!

të na duhet të tregojmë shumë kujdes por dhe respekt për atë që kemi arritur deri më tani dhe sigurisht për kundërshtar-in që nuk duhet nënvlerësu-ar". Lidhur me rreshtimin e organikës së tij në stadiumin e King Abdullah në Jedah të Arabisë Saudite ku dhe do të marrë jetë kjo finale e madhe Allegri zbulon disa të dhëna interesante. "Do të aktivizoj ndonjë prej lojtarëve që nuk mori pjesë në sfidën ndaj Bolognas. Jam i lumtur me gjendjen që paraqesin Douglas Costa dhe Bernardeski që po rik-

uperojnë tërësisht në aspektin fizik dhe psikologjik. Këndira po rikthehet në formën e tij më të mirë duke na treguar të gjithëve lojtarin e madh që njohim edhe pse në pjesën e parë të sezonit pati disa dëm-time. Nga ana tjetër, përballë do të kemi një kundërshtar shumë entuziast pas asaj fito-reje në Kupën e Italisë. Për ta, sikundër dhe për ne, kjo është një ndalesë shumë e rëndësishme. Një sfidë ndaj dy rivalëve historikë, prandaj jemi të detyruar të japim më të mirën".

Trajneri i Milanit me dilema


Gatuzo: Duam trofeun, nuk e di në do ta aktivizoj

Në konferencën për shtyp, para finales së sotme të Superkupës ndaj Juves, trajneri i kuqezinjve, Rino Gatuzo, flet për situatën në kampin e tij, por edhe për një çështje të nxehtë si Higuain. Më herët, ishte "Sky Sports" që kishte deklaruar se Higuain me shumë mundësi është i Çelsit, dhe që këtë të mërkurë, mund të mos jetë në formacion për "Djallin", duke konfirmuar në një farë mënyrë divorcin. "Ka shumë zëra rreth Higuain, por ai po



stërvitet mirë me grupin. Për nesër (sot), do shohim nëse do të luajë apo jo. Ai dëshiron që të marrë një vendim për këtë situatë që po kalon, por është i qetë, dhe gjatë javës është stërvitur mirë. Po i bëj lojtarët të kuptojnë se mund të fitojmë nesër, dhe pas kësaj të fillojmë të ndërtojmë diçka të rëndësishme. Nuk mendoj për arritjen personale, por për lojtarët e mi për të ngritur një trofe.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarat.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë .
- Preka komik shkorrdan.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë .
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishte nija që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishte babai i Akiilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Eduard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtrinë nga "ola".
- Një thirje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditë.

VERTIKAL


- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshhtë kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Maureen që qe aktore.
- Eshhtë tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.
- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshhtë edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamijëve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë tryzni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Iniciale t e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

T	O	K	A	T	L	U	F	R	A	N	Z
A	R	E	S	F	I	M	A				
L	I	N	V	E	N	T	I	L	A	T	O
L	E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E
J	T	E	R	R	O	R	I	S	T	E	T
A	S	A	M	A	R	A	R	A	S		
H	L	O	R	E	N	M	A	R	A	T	I
H	A	M	E	S	T	P	A	R	E	T	I
U	R	I	T	H	S	U	R	R	A	T	I
T	I	R	O	I	D	E	T	I	T	V	O
I	F	N	I	T	A	K	A	S	A	R	
M	E	N	T	E	S	H	T	A	T	E	
M	A	H	L	E	R	K	R	N	O	T	A
I	N	E	S	A	K	O	D	I	E	N	
S	T	R	S	E	N	D	E	R	E	T	
T	E	A	P	E	N	D	I	M	T	A	I
E	N	M	E	N	D	I	M	I	S	G	
R	A	A	C	E	T	E	V	E	L	O	
T	I	R	I	Z	A	N	A	K	I	N	
G	A	K	A	L	S	A	R	N	A		
E	A	B	E	L	M	I	M	E	D		
E	M	E	G	A	T	O	N	T	O	R	
T	O	K	A	A	L	N	D	E	R	A	
P	A	L	A	D	I	N	E	S	T	O	P

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

		3	1					4	
4			3			7		1	
	8			7	9	3	5		
						9			
1								8	
							7		
		8	7			5	3		
	6			5	4	2		9	
9	5								

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	3	8	1	4	9	2	5	
9	2	5	3	6	7	1	4	8	
4	8	1	5	9	2	3	6	7	
5	7	4	9	3	6	8	1	2	
1	9	6	4	2	8	5	7	3	
8	3	2	1	7	5	4	9	6	
2	1	8	7	4	3	6	5	9	
3	4	7	6	5	9	2	8	1	
6	5	9	2	8	1	7	3	4	

Argëtim filozofik

- Njohja e pa-dijes (inorancës) është fillimi i dijes.

- Një njeri i kompletuar ka qetësi për të pranuar gjërat që nuk mund të ndryshojë, ka fuqi për të ndryshuar gjërat që mundet dhe mençurinë për të kuptuar diferencën.

- Mos kini frikë, kur ju ecni ngadalë. Kini frikë vetëm kur ju qëndroni

- Mos kërkë të mësojsh shumë, kërkë të mësojsh të dobishmet.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
3	5	8	2	3	5	6	1	7	5			
12	5	13	5	10	1	7	6			13		
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	
8	2	6	2		2	1	8	5	11	1		
1	6	8		17	9	5	7	2		9		
3	1	5		8	2	16			2	7	1	
2				3	2	6	5	9	2		13	
6	2	7	2			3		7	18	5	6	7
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		

K	O	D	I	A	D	P	A	L			
A	R	E	S	T	I	S	M	L	A		
N	A	D	H	E	R	E	T	I	K	E	T
I	R	M	O	N	I	T	O	R	I		
B	K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E
A	L	A	P	S	A	T	A	A	T		
L	E	A	S	E	T	L	M	T	I		
I	S	R	E	I	N	E	T	I	M		
P	I	S	S	O	D	A	M	O			
S	E	K	R	E	T	L	G	O	L		
A	L	E	L	O	N	D	R	A	R	O	
T	E	T	A	B	D	E	R	A	E	G	

Thënie të mençura

- Një vendim i vogël ka nevojë për logjikë. Një vendim i madh ka nevojë për instinkt.
- E mira ekziston, e keqja duhet të krijohet.
- Liria nuk do të thotë se ju keni kontroll absolut mbi jetën tuaj, do të thotë vetëm që ju mund të zgjidhni atë që dëshironi në një moment të...
- Asnjëherë mos i justifikoni veprimet tuaja. Miqtë tuaj nuk kanë nevojë për këtë, dhe armiqtë tuaj nuk do të ju besojnë gjithsesi.

